

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

19.04.2023
Ora 13.33

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 49, me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë"

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
 - **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
 - **Parti politike:** PS (E. Salianji), PD (I. Sefa)
 - **Të tjerë:** A. Skënderi (avokat i zotit Ismailaj)
- OSBE/ODIHR**

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve. Deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 49, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 366, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe ndalimin e kandidimit të kandidatit për kryetar të bashkisë Mallakastër, shtetasit Qerim Ismail Ismailaj, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Verifikojmë fillimisht prezencën. Është në prezencë të plotë trupa e KAS-it, është prezent përfaqësuesi i ankimuesit, zoti Sefa, është prezent edhe përfaqësuesi i palës së interesuar i zotit Qerim Ismailaj, avokati. Ju lutem prezantohuni.

Z. A. Skënderi: Prezent, avokat Andi Skënderi.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Janë prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata, që në këtë procedim do të përfaqësojnë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. E. Salianji: Dhe Partia Socialiste, Eridjan Salianji.

Z. E. Çefa: Ndjesë, pra edhe avokati i Partisë Socialiste, zoti Salianji. Menjëherë, pa humbur kohë, po ia jap fjalën ankimuesit që të parashtojë shkurtimisht argumentet e tij lidhur me ankimin. Zoti Sefa.

Z. I. Sefa: Faleminderit! Të nderuar anëtarë, i nderuar zoti relator, ankimi është parashtruar gjerësisht në këtë komision të nderuar. Veçoria në këtë rast është që Komisioneri u shpreh në lidhje me themelin e kërkesës së bërë nga Partia Demokratike, e cila ka qenë një kërkesë e përsëritur edhe më parë në lidhje me, në konceptin tonë, kushtet e ndalimit të kandidimit të zoti Qerim Ismail Ismailaj Siç jeni në dijeni, ky kandidat është dënuar me vendimin nr. 11, në mos gaboj, në muajin shkurt të vitit 2023 nga GJKKO-ja, më konkretisht në datën 2.2.2023 me masë dënimi kryesor 6 muaj burgim. Në bazë të vendimit dhe vendimmarrjes së gjykatës, ka përfituar nga gjykimi i shkurtuar dhe nga pezullimi i dënimit në bazë të dispozitave të nenit 63 dhe është dënuar me orë në shërbim të komunitetit, me 40 orë. Ky është vendimi i gjykatës, i cili nuk është ankimuar nga ana e të pandehurit në atë gjykim, zotit Ismailaj, dhe është lënë në fuqi vendimi, që ka marrë fuqi ligjore në datën 29 mars 2023. Zoti Ismailaj në formularin e vetëdeklarimit, në bazë të ligjit nr. 138 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, më shkurt po i them ligji i dekriminalizimit, ka

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

deklaruar në këtë formular, i cili është plotësuar në datën 27, që dënimi ka marrë formë të prerë. Siç jeni në dijeni, ky formular ka pjesë në të cilën deklarohen vendimet e gjykatës, të cilat nuk janë të formës së prerë, ka dënime të gjykatës penale të formës së prerë dhe vendime që nuk janë të formës së prerë. Përveç faktit që e ka relatuar në vendin e gabuar në formular, përsëri ka deklaruar një të dhënë të rreme, që kjo vërtetohet qartësisht nga vendimi i gjykatës, i cili është provë e dosjes gjyqësore, që relatton shprehimisht që ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 29 dhe jo në datën 27, siç e deklaron vetë subjekti. Gjithashtu, ka edhe një të dhënë shumë të rëndësishme, nuk deklaron periudhën e dënuar me burgim, por deklaron vetëm masën e dënimit 40 orë punë në komunitet. Ndërkohë që dispozita dhe vetë formulari përcakton që duhet treguar masa e dënimit me burgim. Pse e ka bërë legjislatori këtë? Sepse në zbatim të nenit 4, pika 9, të ligjit nr. 138 për dekriminalizimin, po i bie shkurt që të mos zgjatem, legjislatori është fare i qartë dhe dua ta referoj, sepse kjo është edhe themeli i ankimit të bërë nga Partia Demokratike: “Ulja e masës së dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në qëllimin e shkurtimit të periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit.”. Pra, ligji thotë që për llogari të këtij ligji dhe për zbatueshmërinë e këtij ligji, legjislatori, e në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë në konsideratë vetëm masën kryesore të dënimit, që është ajo 6 muaj me burgim. Të gjitha procedurat e tjera, siç është gjykimi i shkurtuar, siç është edhe pezullimi i dënimit, nuk merren në konsideratë për efekt të zbatueshmërisë së këtij ligji. Konkretisht çfarë thotë neni 2, shkronja

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

“ç”, i të njëjtit ligj, pra neni 2: “Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj.”. Në bazë të kësaj dispozite 6 muaj, që është dënuar zoti Qerim Ismailaj, përfshihet dhe është në kushtet e ndalimit të pikës 2, gjë që e ka pranuar edhe Komisioneri me vendimmarrjen e tij, që ky 6 muaj në bazë të ligjit duhet të pezullohet, por çfarë thotë Komisioneri? Komisioneri thotë që e ka ekzekutuar dënimin në bazë të dispozitës, sepse është pezulluar me vendim nga gjykata dhe ka ekzekutuar dënimin, 40 orë shërbim publik dhe si rrjedhojë, sipas dispozitës së përgjithshme, thotë, të Kodit Penal, ky person quhet i padënuar për sa kohë që edhe vetë dispozita përcakton që me ekzekutimin e këtij dënimi, dënimi quhet i pakryer. Ajo është dispozita e përgjithshme dhe ajo dispozitë është shtuar në Kodin Penal në vitin 2008. Kur është bërë ligji për dekriminalizimin? Është bërë në vitin 2015. Legjislatori ka qenë në dijeni të këtij parashikimi ligjor, ka qenë legjislator Kuvendi i Shqipërisë dhe ka pas dijeni korrekte me përcaktimet e Kodit Penal, sepse ky ligj është bërë në përputhje dhe në zbatim të Kodit Penal, domethënë një element thelbësor i hartimit të ligjit për dekriminalizimin është elementi i Kodit Penal. Ka qenë vetë legjislatori, i cili thotë që për efekt të zbatimit të këtij ligji, nuk do merren parasysh asnjë nga vendimet, për pezullimin e dënimit. Çfarë është neni 63 në vetvete? Thotë “Pezullimi i dënimit me burgim për kryerjen e një pune për shërbim publik”, që në titull, “pezullim”, e tregon që është pezullim dhe vetë legjislatori e ka hequr për efekt të zbatimit të këtij ligji çdo pezullim dënimi,

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

nuk i merr në konsideratë, merr vetëm masën e dënimit kryesore, që është 6 muaj me burgim. Komisioneri në një vendimmarrje, se nuk dua edhe ta perifrazoj, me thënë të drejtën, por nostalgjik për profesionin që ka kryer më parë, i hyn edhe hierarkisë së normave, ku ndër të tjera thotë që, duke qenë se ky është ligj dhe ky është Kod, Kodi është më i rëndësishëm se ligji. Komisioneri besoj që është konfunduar, se edhe Kodi Penal ligj është në vetvete, por mënyra sesi miratohet, është me 3/5 dhe titulli është “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, por është ligj. Edhe ligji nr. 138 i vitit 2015 është miratuar me 3/5, për të mos thënë që është miratuar me më shumë vota se është miratuar Kodi Penal, që referon Komisioneri. Në dijeninë time, është miratuar me 140 vota. Nuk e di që Kodi Penal është miratuar ndonjëherë me 140 vota, por këtu nuk ka hierarki normash që Kodi Penal do të mbizotërojë mbi dispozitat e ligjit special, që është ligji për dekriminalizimin, madje e kundërta është e vërtetë. Ky ligj që është miratuar mbrapa Kodit Penal, për efekt të zgjedhjeve dhe të plotësimit të kushteve ligjore të kandidatëve për t’u zgjedhur, dispozitat e përcaktuara në të duhet të prevalojnë mbi ato të Kodit Penal, vetëm për efektin për personat që zgjidhen për funksionet publike, sepse ky ligj, kur është hartuar, i ka pasur në konsideratë dispozitat e Kodit Penal, por, megjithëse i ka pasur në konsideratë dhe ka pasur njohuri të mjaftueshme për to, përsëri ka vendosur t’i përcaktojë këto dispozita, ndaj interpretimi i zgjeruar dhe jo fort i mbështetur në ligj i Komisionerit, bie ndesh edhe me atë që është praktika gjyqësore, por edhe me atë që është hierarkia e normave, që ai vetë i referohet. Nuk mund të ketë përcaktime të përgjithshme, nuk mund të mbizotërojnë mbi përcaktimet e posaçme për një dispozitë të caktuar që lidhet vetëm me zgjedhjet. Kodi Penal i shtrin efektet në të gjithë territorin shqiptar për të gjithë qytetarët shqiptarë, ndërsa ligji për dekriminalizimin është për ata që duan të konkurrojnë, është për ata që duan të jenë pjesë e pushtetit administrativ, qendror e të gjithë me radhë. Ndaj ky ligj i posaçëm

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

ka efekte të përcaktuara qartë dhe mënyra e trajtimit të dispozitave ligjore është vetëm për personat që duan të zgjidhen për funksione publike. Kodi Penal është gjeneralist, është për të gjithë. Ligji për dekriminalizimin është specifik për një gamë të caktuar njerëzish ose për personat që duan të ushtrojnë funksione publike, ndaj nuk mund të prevalojë Kodi Penal në dispozitat e përgjithshme mbi ligjin e posaçëm. Ne mendojmë që ky përcaktim që thamë edhe më sipër ka ekzistuar që nga koha kur është përcaktuar e drejta në këto trojet tona, që nga e drejta romake e në vijim dhe e përcakton fare qartë si do të jetë mënyra e trajtimit të këtyre situatave. Komisioneri ka marrë një interpretim të zgjeruar të të gjithë situatës dhe ka vendosur që nuk jemi në kushtet e ndalimit, sepse ka ekzekutuar dënimin dhe e ka bërë dënimin dhe sipas ligjit ky dënim nuk ekziston, ndërkohë që dispozita, neni 4, pika 9, është e qartë për zbatimin e këtij ligji merret vetëm masa e dënimit me burgim. Në bazë të kësaj dispozite këtij shtetasi duhej t'i ndalohej kandidimi për një periudhë 2-vjeçare dhe këtë e përcakton neni 69, që thotë: “Për dënime deri në 6 muaj, rehabilitimi është 2 vjet”. Zotërisë i lind e drejta për të rikandiduar përsëri vetëm pas datës 29 mars të vitit 2025. Deri në atë datë zotëria nuk ka të drejtë të jetë pjesë dhe të jetë garues në zgjedhjet lokale apo në zgjedhjet e përgjithshme. Gjithashtu, nuk ka të drejtë të jetë drejtues në organet që përcakton në dispozitën ligjore, të cilës ne iu referuam më parë, që është neni 2 i ligjit nr. 138. Është shumë e qartë që zoti Ismailaj është dënuar me 6 muaj burgim dhe kjo është masë ndaluese për sa i përket dispozitës së ligjit, sepse ligji thotë që të mos jesh subjekt i këtij ligji, duhet të jesh dënuar me vendim penal më të vogël se 6 muaj, pra masa e dënimit 6-mujor përfshihet në kushtet e ndalimit. Ne mendojmë që vendimi i Komisionerit është i padrejtë, është i pabazuar në ligj dhe si i tillë duhet të shfuqizohet nga KAS-i, i cili duhet të marrë vendim për ndalimin e kandidimit të subjektit Qerim Ismail Ismailaj, i cili është në kushtet e ndalimit të ligjit. Siç edhe Komisioneri në vitin 2020 mori vendim, fatkeqësisht ky

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

është një rast i përsëritur nga këto organe, që nuk është në kushtet e ndalimit dhe nuk i ndërpreu mandatin e kryetarit të bashkisë, gjithashtu edhe KAS-i vendosi në të njëjtën formë, ka qenë insistimi dhe persistimi i Partisë Demokratike, e cila ka qenë e bindur në provat dhe faktet e përmendura prej saj, ka bërë kallëzim penal dhe në fund rezultoi që pretendimet e Partisë Demokratike ishin të vërteta, ishin të qenësishme dhe si pasojë e këtij insistimi zoti Ismailaj është dënuar nga Gjykata e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, e cila e gjeti atë fajtor për falsifikim të dokumenteve zyrtare. Ndaj mendoj që ky komision duhet të vlerësojë dhe të pranojë ankimin e paraqitur nga Partia Demokratike dhe të ndalojë kandidimin e zotit Qerim Ismailaj si kandidat i Partisë Socialiste për Bashkinë Mallakastër. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit, zoti Sefa! Sekretari i Përgjithshëm, në këtë fazë keni ndonjë prapësim në emër të Komisionerit, apo do ta rezervoni të drejtën ta ngrini në formë parashtrësash apo përgjigje pyetjesh? Ok. Përfaqësuesi i personit të interesuar, zoti Salianji e ka fjalën.

Z. E. Salianji: Faleminderit! Parashtrimet i kemi me shkrim, do t'jua depozitojmë. Nuk dua të zgjatem në përsëritje, por ne do të mbajmë qëndrimin që kemi mbajtur edhe në seancën që kjo çështje është shqyrtuar nga Komisioneri. Së pari, unë do të thosha që, pavarësisht vendimit që ju morët ditën e djeshme për ta futur në shqyrtim këtë çështje, unë theksoj faktin që kjo çështje nuk është për t'u gjykuar nga KAS-i, sepse ne me këtë gjykim që ne po i bëjmë këtij rasti e gjykojmë që pas KAS-it vjen Kolegji, pas Kolegjit vjen gjykata e shkallës së parë, e do ta bëjmë me 5 shkallë shqyrtimin e kësaj çështjeje, gjë që nuk besoj se ligji e lejon, megjithatë ju e keni marrë këtë vendim, dhe për shkak se kjo çështje do të shkojë në gjykatë, unë jam i

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

detyruar ta përmend këtu para jush. Për mendimin tonë, kjo çështje do të shkonte për kompetencë në Gjykatën Administrative për arsye se organi shtetëror, në këtë rast, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, e ka dhënë mendimin e tij, i lejohet apo jo të kandidojë, si në rastin që kur u vendos për heqjen e mandatit çështja shkon në Gjykatën Administrative. Është një praktikë tashmë e konsoliduar për sa i përket zbatimit të ligjit të dekriminalizimit dhe jam i detyruar tani të parashtroj në lidhje me pretendimet që ngre ankuesi. Unë besoj se këtu ne do t'i referohemi ligjit dhe ta interpretojmë ligjin në mënyrën sesi ne e kuptojmë ligjin për sa i përket shkeljes së pretenduar. Në qoftë se do të ishin të drejta të gjithë pretendimet që tha ankuesi, atëherë ligji për dekriminalizimin do të kishte një nen: ndalohet kandidimi i personave që dënohen nga Kodi Penal me 6 muaj burg dhe këtu e kishte mbyllur legjislatori për as u përket të drejtave që kanë kandidatët për të garuar në një proces zgjedhor. E drejta për të garuar është një e drejtë kushtetuese, e cila mund të ndalohet vetëm me ligj dhe ky është ligji që ne duhet të lexojmë sot. Për sa i përket dispozitës ka qenë shumë i qartë, nuk është harruar vendosja e këtij lloj dënimi që ne po gjykojmë sot. Legjislatori ka qenë shumë i qartë në përcaktimin se cilat janë: në nenin 4, pika 9 thotë që vetëm vendimet e dënimit me 6 muaj burg, pezullimi, lloji i dënimit, kushti. Në qoftë se do të kishte dashur të vendoset edhe dënimi me punë të detyruese, do ta vendoste, por nuk e ka vendosur me qëllim, për arsye se kjo është një vepër që të quan të padënuar dhe këtu do të kishim pastaj konfondim dispozitash, do të kishim humbjen e një të drejte. Pra, vetë vendosja në Kodin Penal e kësaj dispozite është një dispozitë në të cilën për të pandehurin, në rastin kur dënohet dhe nuk kryen dënimin, quhesh i dënuar, në rastin kur e kryen dënimin quhesh i padënuar, dhe këtu jemi përballë faktit që është kryer dënimi dhe mbas kësaj vepra quhet i padënuar dhe në aplikimin e dëshmisë së penaltetit kjo vepër nuk shënohet. Nuk mundet që me ligj të veçantë, ligji i dekriminalizimit, ne këtë person ta quajmë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

të dënuar, se këtu do të kalojmë përballë faktit që jemi në një situatë që ia heqim, e ndalojmë kandidimin. Çfarë do të thotë? Ne e quajmë të dënuar, në qoftë se hiqet kandidimi, do të thotë që jemi në kundërshtim me Kodin Penal, atëherë t'ia shënojmë te dëshmia e penaltetit që është i dënuar, se e vendosi KAS-i ose Kolegji Zgjedhor nesër, që ky person është i dënuar, kur vetë ai i cili e ka kompetencë, prokurori, që ka kërkuar dënimin e këtij, ka një provë aty që e kemi depozituar, që thotë është i padënuar, vetë prokurori i cili e ka dënuar. Tani kjo është një dispozitë e cila nuk parashikohet në ligjin e dekriminalizimit si gjithë dispozitat përjashtuese që ka lënë legjislatori. Prandaj e lidh me fillimin që thashë, se legjislatori ka qenë shumë i qartë për sa u përket neneve që ka vendosur dhe neneve që ka përjashtuar nga dekriminalizimi, që nuk ndalohet kandidimi, si dhe benefiteve. Ky është një benefit që ka i pandehuri dhe këtë benefit e ka lënë të palëvizur legjislatori dhe nuk e ka futur në ligjin e dekriminalizimit. Pse nuk e ka futur? Nuk është qëllimi i ligjit të dekriminalizimit të gjykojë personat të cilat marrin këtë lloj dënimesh, ligji dekriminalizimit është bërë për një qëllim më të madh: të ndalojë personat që dënohen për korrupsion, të ndalojë personat të cilët dënohen për vepra penale të trafikimit. Kjo lloj vepre, e cila parashikon këtë lloj benefiti, janë vepra të lehta, të cilat nuk parashikohen në ndalim. Siç nuk parashikohen vepra në ndalim, s'mund të parashikohet edhe benefiti, lloji i kryerjes së dënimit. Prandaj do të thosha që pavarësisht numrave që mund të jetë votuar ky ligj, pavarësisht asaj marrëveshjeje që është krijuar ky ligj, nuk mundet që një benefit që e ka dhënë Kodi Penal, që në të vërtetë unë jam me mendimin e Komisionerit që mbas Kushtetutës vijnë kodet dhe pastaj vijnë ligjet e tjera, se këto e mbajnë sistemin, hierarkia e ligjeve, besoj se ky ankim do të rrëzohet, se nuk ka edhe qëllimin që vete legjislatori i ka dhënë ligjit të dekriminalizimit. Nuk është qëllimi të përjashtohen nga kandidimi ose t'u hiqet mandati personave që dënohen me punë detyruese, ka tjera qëllime që është miratuar

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

ky ligj për pastrimin e politikës; persona të cilët kryejnë vepra, siç e thashë më sipër, korrupsioni, pastrimi i parave, vjedhje etj., se s'mund të marrësh një dënim të lehtë për të tilla veprash. Prandaj, qëllimisht nuk është përcaktuar në këtë ligj dhe përderisa nuk e përcakton ligji i dekriminalizimit këtë lloj vepre, që quhesh i paqenë edhe ne s'mund ta gjykojmë këtë. Për sa më sipër, rrëzimin e ankimit dhe lënia në fuqi të vendimit të Komisionerit. Faleminderit!

Z. E. Çefaj: Ju faleminderit! Avokati i zotit Ismailaj, doni të shtoni gjë?

Z. A. Skënderi: Jo, i nderuar kryetar, vetëm një sqarim ekstra, duke qenë se dëgjova dhe fjalën e përfaqësuesit të Partisë Demokratike në lidhje me dispozitën. Në Kodin Penal neni 63 është i vetmi në të gjithë dispozitat e tjera i cili nuk cenon statusin juridik të personit dhe kjo përbën diferencën direkte në lidhje me interpretimin që donte t'i bënte Partia Demokratike asaj pikës 9 që konsiderohet gjasme si e harruar, por nuk është e harruar. Për sa kohë statusi juridik i personit konsiderohet i paqenë dhe nuk shënohet fare në regjistër si person i dënuar, është e vetmja dispozitë që ia jep këtë mundësi një personi për shkak të rrezikshmërisë të pakët, duke e konsideruar të paqenë fare. Kështu që për sa kohë statusi juridik merr këtë trajtim nga vetë praktika, teoria e së drejtës jo sot po historikisht qëkur ka lindur kjo e drejtë për të pandehurin, në këto kushte duhet që ju, si komision ta vlerësoni dhe në këtë aspekt, duke qenë se edhe vetë përfaqësuesi i Partisë Demokratike tha se ligji nr.138 referonte Kodi Penal, kështu që kjo referencë nuk mund të dalë jashtë këtij kuptimi që i ka dhënë edhe praktika gjyqësore shqiptare. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë nga kolegët pyetje, në qoftë se keni?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Rusmali: Unë kam, në fakt, pyetje, por ë parën e dua për të dyja palët që janë këtu. Domethënë edhe një herë ju e keni thënë besoj edhe në materialet që keni parashtruar, po e dua edhe një herë me gojë për seancën. Në vlerësimin tuaj të ankuesit dhe të palës së interesuar, kandidati Qerim Ismailaj është dënuar me 6 muaj burg, apo është dënuar me 40 orë punë? Ju pastaj ju.

Z. E. Saliari: Është dënuar me 6 muaj burgim dhe në bazë të dispozitave të Kodit.

Z. I. Rusmali: Pjesën tjetër e dimë, opinionin juaj.

Z. A. Skënderi: I nderuar anëtar i trupës, po të shikohet dispozitivi i vendimit të gjykatës...

Z. I. Rusmali: Njëra apo tjetra, është dënuar me 6 muaj burg, apo 40 orë?

Z. A. Skënderi: Me 40 orë, ai ato ka kryer.

Z. I. Rusmali: Dakord, është dënuar me 40 orë.

Z. A. Skënderi: Nuk ka kryer 6 muaj.

Z. I. Rusmali: Mirë, dakord faleminderit! Pyetja tjetër që kam për përfaqësuesin e Partisë Demokratike. Ju në materialin në ankim keni parashtruar, jua thashë edhe në seancën paraprake, një numër argumentesh sipas të cilave ju ngrini pretendimin që Qerim Ismailaj ka kryer edhe një vepër tjetër penale me këtë plotësimin e

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

vetëdeklarimit, madje kërkoni që Komisioneri Shtetëror edhe të bëjë kallëzim penal për të, ju vetë keni bërë kallëzim penal?

Z. I. Sefa: Komisioneri Shtetëror e ka për detyrë si funksionar publik në momentin që vihet...

Z. I. Rusmali: Pyetja është: ju a keni bërë?

Z. I. Sefa: Një herë e kemi bërë ...

Z. I. Rusmali: Jo, tani keni konstatuar shkeljen, domethënë kryerjen e një vepre penale. Të lutem, thoni detyrimi është për këdo, i pari fare Komisioneri, këtë e kam lexuar e kam të qartë. Jam duke ju pyetur: ju keni bërë kallëzim, apo jo?

Z. I. Sefa: S'po na lë radhë Komisioneri me vendimet që po merr, se jemi investuar totalisht në KQZ.

Z. I. Rusmali: Kjo do të thotë që nuk keni bërë kallëzim.

Z. I. Sefa: Aktualisht, jo.

Z. I. Rusmali: Keni plan të bëni?

Z. I. Sefa: Po do ta vlerësojmë patjetër, siç bëmë edhe radhën e parë dhe rezultoi që ishte kallëzim i provuar.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Rusmali: Dakord, faleminderit! Të lutem, pyetje-përgjigje, se harxhojmë kohën e njëri-tjetrit kot...

Z. I. Sefa: Tani juristët nuk janë kaq preciz, zoti...

Z. I. Rusmali: Janë gjithmonë preciz, janë si matematikanët. Çështja është tjetër pastaj se kush e shfrytëzon, juristët kanë precizionin e matematikanit, po i qëndrojmë gjësë, të mos shpërndahe mi. Tani besoj ky është interpretim ligjor dhe do më interesonte opinionin e të dyjave palëve. Ju e keni mbështetur argumentin tuaj për ndalim në themel të neni 4 pika 9 e ligjit të dekriminalizimit. Neni 4 titullohet: "Periudha e ndalimit të kandidimit zgjedhjes apo ushtrimit të një funksioni të zgjedhur ose të emëruar." Periudha e ndalimit, pika 9, teksta përmend të gjitha ato gjëra që i thonin të dyja palët, shpjegon edhe qëllimin e dispozitës së pikës 9, dhe qëllimi i dispozitës është ndalohe, nuk përlllogaritet ulja e masës dënimit dhe të gjitha gjërat e tjera, për qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj, është e shkruar këtu. Tani, pyetja që kam unë është: kjo dispozitë vlen vetëm për përlllogaritjen e periudhës së ndalimit, apo vlen edhe për zbatimin e nenit 2, që përcakton veprat penale për të cilat nuk lejohet kandidimi? Është për të dyja palët kjo pyetje.

Z. I. Sefa: Siç e shpjegova edhe më sipër dispozita lidhet me mënyrën se si do merret masa e dënimit ose dënimi për llogari të këtij ligji dhe ky ligj është fare i qartë. Thotë për llogari të këtij ligji do të merret vetëm dënimi kryesor dhe dënimi kryesor në këtë rast është 6 muaj burgim. Për efekt të këtij ligji, ai vendim gjykate nr.11, datë 2.2.2023, shërben vetëm pika e parë e atij dispozitivi, që thotë 6 muaj burgim. Të gjitha dispozitat e tjera, në bazë të pikës 9, nuk hyjnë në përlllogaritje ose për efekt

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

të zbatimit të këtij ligji. Dhe dispozita që i referoheni ju është vetëm për pjesën e ndalimit dhe thotë për arsye, sepse e lidh edhe me nenin 69 të Kodit Penal, që janë edhe afatet e parashikuara të parashkrimit të veprës penale, të rehabilitimit. Dhe thotë për efekt të këtij ligji do të merret vetëm masa e dënimit. Madje legjislatori është aq i zgjuar sa nuk quan as gjykim të shkurtuar, as depenalizimin, as amnistinë, nuk quan asnjë nga rrethanat favorizuese, që mund të marrë legjislatori në moment ose në të ardhmen. Prandaj i referohet shprehimisht, që për efekt të zbatimit të këtij ligji, merret vetëm masa e dënimit me burgim. Të gjitha procedurat e mëparshme pezullim, pa pezullim, me gjykim të shkurtuar nuk i konsideron ky ligj.

Z. I. Rusmali: Pra, që ta kuptoj drejt unë përgjigjen tuaj, dispozita e pikës 9 të nenit 4 ka lidhje me ligjin dhe jo me mënyrën e përlllogaritjes së periudhës së ndalimit...

Z. I. Sefa: Me mënyrën e përlllogaritjes së periudhës së ndalimit pika 9, dhe po jua shpjegoj, për këtë arsye thotë legjislatori...

Z. I. Rusmali: Ka lidhje me këtë gjë, apo ka lidhje me zbatimin e ligjit? Se janë dy gjëra të ndryshme.

Z. I. Sefa: Po periudha e ndalimit është për të zbatuar ligjin.

Z. I. Rusmali: Periudha e ndalimit është një...

Z. I. Sefa: Dhe thotë zotëria që është ndaluar me 6 muaj burgim, duke ia hequr gjithë këto të tjerat...

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Rusmali: Periudha e ndalimit është komponenti i ligjit që përcakton që nga kjo datë deri në këtë datë nuk ju lejohej të ushtroni funksione publike. Kjo është periudha e ndalimit. Është vetëm për këtë, apo është për zbatimin e ligjit në tërësi?

Z. I. Sefa: Po zbatimi i ligjit varet nga pika 9 po ju them, sepse pika 9, ku i drejtohet Komisionerit dhe organeve ligjzbatuese, dhe thotë ky zotëria që është dënues me 6 muaj burgim, ti në vendim gjykate mos i llogarit të gjitha pikat e tjera, merr vetëm dënimin kryesor. Dënimi kryesor është 6 muaj burgim dhe thotë në bazë të këtij ligji, ky 6 muaj burgim do të ndalohej 2 vjet dhe zotëria lejohej të kandidojë më 29 mars të vitit 2025. Edhe atë që thashë për veprën penale, që e referuat edhe më parë, që nuk e përfundova lidhet me faktin që zotëria ka deklaruar përsëri një të dhënë të rreme. Ka deklaruar në formularin..

Z. I. Rusmali: Kjo është temë tjetër.

Z. I. Sefa: Më lër ta mbaroj, se është e rëndësishme për mua.

Z. I. Rusmali: Mirë, po do t'u përgjigjesh pyetjeve. Kur të japësh pretendimet e tua, do të thuash çfarë të duash, tani pyetja ka objekt. Do t'i përgjigjesh pyetjes. Nuk do të hapërdahemi as unë, as ti. Mund ta marr përgjigjen tuaj për këtë pyetje, apo nuk keni përgjigje?

Z. A. Skënderi: Ne, i nderuar anëtar, mendoj se i shpjeguar në përfundim të fjalës, meqenëse më pyeti kryetari, në lidhje me kuptimin e nenit 63. në qoftë se do t'i

Z. I. Rusmali: Është tjetër...

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. A. Skënderi: Jo, jo do të dal te pyetja. Në qoftë se do t'i qëndrojmë kësaj logjike, duke lexuar nenin 9 në këtë formë, siç pretendon Partia Demokratike, do të denatyrizojmë komplet kuptimin e dispozitave penale, sepse, ai në fund të herës, kandidati, zoti Qerim Ismailaj, ka vuajtur, po themi, 40 orë punë publike dhe ato garanci që atij i janë dhënë, vetë dispozita e 63-shit thotë: “zëvendësimin e dënimit”. Në asnjë dispozitë tjetër nuk thuhet fjala “zëvendësimin”. Pra, jo rastësisht edhe legjislatori në Kodin Penal...

Z. I. Rusmali: Shiko unë kam nevojë për ndihmë dhe prandaj bëj pyetje. Kërkesa ime për ndihmë është kjo: dispozita e nenit 9 i referohet vetëm periudhës së ndalimit. Pra, përlllogaritjes së periudhës së ndalimit, sipas nenit 4, apo i referohet të gjithë ligjit? Apo i referohet edhe nenit 2 që përcakton veprat penale dhe dënimet respektive për të cilët nuk lejohet ushtrimi funksioneve? Është shumë e thjeshtë: ose është njëra, ose është tjetra. Po jo Kodi Penal 63, se nuk po kërkoj atë.

Z. A. Skënderi: E qartë. Nga leximi i pikës 4, periudha e ndalimit dhe parashikimet që janë këtu, në referim të pikës 2, këtu flitet për tërësinë e të gjithë periudhës. Pra, nga leximi i tre, katër pikave në rend, sepse pika 9 është e fundit dhe është në kronologji me pikat tjera përpara, nuk është e shkëputur, e pavarur, sepse thotë nga momenti i përfundimit. Në qoftë se është nga momenti i përfundimit dhe ky periudhën e përfundimit e ka bërë përpara kësaj periudhe, atëherë pika 9 nuk e konsideron dot, po ta lexojmë literalisht kështu si dispozitë referuese, meqenëse po kërkon këtu përgjigje. Pra, nëse një person konsiderohet i padënuar dhe i paqenë dënimi dhe këtu e lidh me përfundimin e dënimit, atëherë ne jemi pikërisht para këtij momenti, që nuk është subjekt i ndaluar, sipas pikës 2. Pra, po e lidh po me fjalët e

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

nenit vet, brenda nenit, të cilat referojnë pastaj edhe te pyetja që ju thoni. Kjo është logjika e ndërtimit të kësaj dispozite.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Edhe unë kam një pyetje. Urdhëroni, meqenëse nuk dua të ndërpres arsyetimin!

Z. I. Sefa: Do t'u referohem posaçërisht dispozitave të Kodit Penal. Kodi Penal ka vetëm dy vepra ku referohet termi "pezullim". Është neni 59 që thotë "pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë" dhe neni 63, që thotë: "pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik". Tani legjislatori, siç jua thashë, Kodin Penal e ka ditur, por te neni 4 pika 9, thotë vetëm "pezullim dënimi", nuk thotë pezullim dënimi sipas nenit 59. Domethënë me këtë logjikë i bie që edhe pezullimi i dënimit sipas nenit 59 vënien në provë nuk është më në kushtet e ndalimit, apo jo? Tani ose janë të dy ose nuk është asnjë, sepse mënyra si llogaritet në fund pastaj, kur shlyhen orët në shërbimin publik a quhesh i dënuar apo jo, nuk ka thënë gjë legjislatori, nuk ka hyrë fare këtu. Ai thotë pezullimi i dënimit nuk konsiderohet. I bie shkurt. Ose e ka ky ligj gabim, dhe ne duhet ta ndryshojmë, por nëse e është gabim ligji, por ligji, kështu siç është, i përfshin të dyja. A jemi ne kompetentë këtu për të thënë, që dispozita është bërë pak ndryshe dhe duhet të ishte bërë pak më ndryshe, është diskutim tjetër, por nuk kemi ne kompetencë. Legjislatori t'i hyjë hyrë, të thotë: po kemi bërë një gabim atëherë, kemi thënë vetëm pezullimi i dënimit, duhet të thoshim pezullimi i dënimit sipas dispozitave të nenit 59. Të citojë këto ai, 63-shi nuk quhet, por të bëjmë diferencim se ai pezullimi dhe vënia në provë është ndryshe, ndërsa ky pezullimi tjetër dhe puna në interes publik është ndryshe, kjo nuk na takon, nuk na takon ne t'i hyjmë këtij diskutimi fare. Ne lexojmë dispozitën pezullim dënimi. Unë e shoh

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

shumë ngushtë për veten time. Pezullim dënimi -thotë ai -nuk konsiderohet për efekt të zbatimit të këtij ligji. Kaq.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë unë kam një pyetje për përfaqësuesin e Partisë Socialiste dhe përfaqësuesin e zotit Ismailaj. Hipotetikisht nëse, po supozoj tani, sepse dua ta kuptoj qëndrimin tuaj më mirë, nëse gjykata do të ishte mjaftuar vetëm me deklarinim fajtor të zotit Ismailaj dhe aplikimin vetëm të gjyqimit të shkurtuar, sipas jush, pra nuk do të ishte shprehur për aplikimin e nenit 63, po do ta kishte ndaluar këtu dispozitivin, pra sipas jush zoti Ismailaj, a do të ishte në kushtet e ndalimit, apo jo?

Z. E. Salianji: Hipotetikisht mund të kishim edhe ndonjë vendim tjetër, edhe pafajësi nga ajo gjykatë. Tani po erdhëm për hipotetike këtu nuk ka. Këtu ligji është shumë i qartë, ose të dënon, ose të jep pafajësi, ose llojet e dënimit. Tani, nëse legjislatori, ne, ju, gjykata nuk do ta quajmë llojin e vendimit, dënim në interesin publik, dhe ne ta shënojmë me vendim KAS-i, nuk e ka shënuar, pezullimi i ekzekutimit bëhet për veprë të rëndë. Dënohesh 5 burg, pezullohet dënimi, pra këtë ka pasur ide ai që e ka shënuar. Liri me kusht, thotë, mos lejo, dënohesh 7 vjet 5 vjet pezullohet pjesa e mbetur me kusht. Këtu nuk jemi këtu dhe qëllimi, siç e thashë në fillim, i legjislatorit për ligjet e dekriminalizimit nuk ka qenë për të penalizuar kandidimin e dënimeve të lehta, por për të hequr nga sistemi i kandidimit dhe sistemi politik, persona që dënohen me vepra të rënda. Ky lloj dënimi vetë që jepet në raste shumë të rralla, për vepra shumë të lehta siç është dhe kjo veprë. Cila veprë është? Mosdeklarimi në formularin e dekriminalizimit. Pra, legjislatori vetë, unë po e them këtu dhe thashë është një ligj i ri një eksperiment i ri ky ligj i dekriminalizimit, mund ta kishte vënë që kur falsifikon kur harron të shënosh dhe nuk mund të dënohesh.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Pra, ti përjashtohesh nga kandidimi se nuk ke shënuar një të dhënë tënden. Kjo është vepra penale, këtë ka pasur në mendje i gjithë Kuvendi 140 veta që të nxjerrim nga sistemi persona, të cilët harrojnë të shënojnë të dhënat e tyre në formularin e dekriminalizimit? Pra, përjashtohesh nga mandati për arsye se je i dënuar për mos deklarimin e një të dhëne në formularin e dekriminalizimit. Atëherë, kjo është një vepër e re, që ne e shënojmë. Pra, për këtë lloj vepre, e ka dhënë Kodi Penal këtë benefit dhe ne kështu duhet ta gjucojmë. Është lloj i dënimit, nuk është as dënim me kusht as pezullim dënimi, përjashton amnistinë. Me fare të drejtë amnistohet se ka vepra penale të cilat duhen 3 vjet të amnistohen dhe ti nuk mund të vish dhe të marrësh vendimin e amnistisë dhe të thuash po unë do të kandidoj, sepse është një vepër e rëndë pas asaj amnistie që është kryer. Pra, ke pasur një dënim për shpërdorim detyre, dhe ke fituar amnistinë, por nuk mund të vish këtu e të thuash se unë tani jam amnistuar dhe dua të kandidoj. Po, patjetër e ka pasur këtë qëllim. Kurse rasti konkret duhet gjykuar siç është rasti. Dënimi konsiderohet i paqenë. Dënimi është siç u bë pyetja në fillim, dënim me 40 orë, nuk është dënim me burgim, ky është përfundimi dënimit. Ne lexojmë atë çka kryhet dhe ne kemi kryer këtë lloj dënimi. Nëse ne do të kishim kryer dënimin me burgim, atëherë tani ne jemi dënuar me 40, kemi kryer 40 orë punë kemi një vendim që po kreve këtë dënim qhesh i paqenë dhe ne këtë duhet të diskutojmë sot. A është ky te ligji i dekriminalizimit apo jo? Janë të gjitha benefitet, këtë lloj benefiti nuk e ka parashikuar dhe dhashë e arsyetimit pse nuk e ka parashikuar.

Z. E. Çefa: Avokat, tani arsyeja pse unë pyeta është se është evidente që kjo çështje është interpretim ligji. Ne të gjithë jemi juristë dhe unë dua, që, sikurse e tha kolegu Rusmali dua që të më ndihmoni që edhe unë ta interpretoj qartë. Prandaj bëra

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*


pyetjen, për ta parë në një këndvështrim tjetër interesimin e të njëjtës dispozitë nga ana juaj.

Z. I. Rusmali: Unë kam pyetje për avokatin e zotit Qerim Ismailaj. Kolegu juaj tha që personi quhet i padënuar. Pse e ka plotësuar formularin ai me këtë vendim?

Z. A. Skënderi: Formulari në rubrikat e tij kërkonte të gjitha dënimet, gjykimet, që ka pasur gjatë eksperiencave të jetës personi që kandidon, për t'i deklaruar me qëllim verifikimin nga organi përkatës thuhej. Po të mos e deklaronte fare do të vinte prapë Partia Demokratike këtu dhe të thoshte që prit se ka një vendim gjykate, ndërkohë që kjo ka qenë një çështje publike. Dhe ai ka deklaruar edhe dënimin për të cilin po ngrihen prapë debate, nëse ka qenë 40 orë apo 6 muaj. Pra, po të mos e nxirrte fare bie, në formular ka shkruar edhe dënimin e Greqisë, dhe të Shqipërisë, dhe periudhat që përputhen me të vërtetat e jetës së tij si kandidat që vjen para këtij komisioni me qëllim mosshmangie të asgjëje nga dyshimet e arsyeshme që mund të krijohet në të ardhmen, siç ndodhi më herët. Por kjo nuk do të thotë që dispozitivi dhe vendimmarrja e gjykatës ndikon te mënyra e plotësimit të formularit te vërtetësia e të dhënave të tij. Kjo është arsyeja pse i ka deklaruar.

Z. L. Braho: Në fakt, pyetja ime e parë ishte e njëjtë me pyetjen që bëri zoti Rusmali, sepse përderisa dënimi është i paqenë, pse është i plotësuar. Edhe unë dua ta lidh me formularin, dhe formulari i deklarimit është miratuar me vendimin e Kuvendit. Dhe në formular këtë pjesën që ka plotësuar zoti Ismailaj, te të dhënat e vendimit gjyqësor, pra te seksioni 3 pyetja 1 është gjykata, numri dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe thotë masa e dënimit me burgim. Dhe me sa kam parë unë formularin aty nuk është shënuar masa e dënimit me burgim, por është

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

shkruar me orë pune. Tani, po të hyjmë në qëllimin e ligjvënësit, sepse ligjvënësi ka parashikuar, i është referuar Kodit penal që dënimet kryesore janë me burgim të përjetshëm, burgim dhe me gjobë në rastin e krimeve. Dhe ky është krim neni 190. Dhe jo më kot e ka shkruar masa e dënimit me burgim. Pra, këtu duhet shënuar masa e dënimit me burgim, ndërkohë ju keni shënuar atë me orë. Tani prapë debati është që, nëse konsiderohet i paqenë, pse është plotësuar kështu, dhe meqë ju e keni plotësuar pse nuk keni shënuar dënimin kryesor që është vendosur dhe jo alternativën?

Z. A. Skënderi: Arsyen e shpjegova dhe më parë kur dhashë përgjigje pyetjes së anëtarit tjetër të trupës. Kandidati ka dhënë numrin e vendimit të saktë, siç e ka dhënë gjykata me të gjitha të dhënat konkrete. Dhe këtë plotësim e ka bërë për transparencën për kandidimin që do të bëjë në raport me çështjet që ai ka pasur gjatë jetës së tij, qoftë ato që i kanë ndodhur në Greqi, pa qenë kandidat fare, qoftë edhe atë që i ndodhi në Shqipëri me kallëzimin e Partisë Demokratike. Por në asnjë moment nuk shënuar faktin që ka qenë me 6 muaj bëra 40 ditë dhe të jepte një shpjegim të gjatë, sepse rubrikat ishin të shkurtra dhe në logjikën e plotësimit të këtyre rubrikave ka dhënë shpjegimin që dënimi vuajtur të cilin ai realisht ka vuajtur ka qenë ai me 40 orë dhe ka dhënë edhe numrin e vendimit me qëllim, sepse formulari në fund fare ka disa fjali ku thuhet do të kryhet verifikimi mëtejshëm në lidhje me deklaratimet tuaja. Dhe për të qenë transparent me komisionin, që do të bënte kryerjen e këtyre verifikimeve, ka dhënë të dhëna të plota për atë që realisht është e vërteta. Dhe më pas ne i plotësuam dhe me aktet që solli vetë Prokuroria e Posaçme që konfirmonin pikërisht këtë masë dënimi të vuajtur nga ky subjekt dhe pasojat ligjore të statusit juridik të këtij subjekti në raport tashmë të krahasuar me ligjin nr. 138, që ky subjekt nuk mund të jetë në kushte ndaluese. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. E Çefa: A ka pyetje të tjera? Po, zoti Bele.

Z. K. Bele: Në fakt, pyetja ime është në vazhdim të pyetjeve se të njëjtën pyetje që do të ngrija unë u ngrit në disa mënyra dhe ju bërë një shpjegim, se te ligji, pavarësisht se është shkruar në mënyrë që ne nuk mund ta ndryshojmë, interpretimet ne i lexojmë në mënyra të ndryshme, prandaj dhe ka mendime të ndryshme. Pra, në atë që ju artikulluat në fund, nëse unë e kuptova drejt, ju thoni që personi për ju është i padënuar pasi kjo reflekton gjendjen e tij gjyqësore, sipas dëshmisë së penaltetit, por për të shmangur keqkuptimet dhe në interpretim të vendimit të Kuvendit, formulari i tij dhe ju e keni shënuar në atë formular, por ju i qëndroni faktit që në kuptim të ligjit personi, duke iu referuar Kodit, është i padënuar.

Z. A. Skënderi: Po, sepse mund të ndodhte, i nderuar anëtar, duke qenë se kjo pika 9 e këtij ligji lë këtë shtegun, po themi, 1% të këtij diskutimi që po bëjmë të gjithë juristët në këtë sallë, kandidati, duke qenë se pati një eksperiencë negative më herët nga kjo gjë, u detyrua, ky është qëllimi, por nuk i ka ikur në asnjë moment 40 ditëshit të burgut.

Z. K. Bele: Pra, këtu ndahemi, jo është nga ato vendime që nuk e kap ligji, por ju thoni është i padënuar.

Z. A. Skënderi: Është i pa dënuar realisht. Ky është statusi i tij juridik.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. E. Çefa: Mirë, atëherë, meqenëse edhe kjo fazë mund të konsiderohet e mbyllur do të kalojmë në konkluzionet përfundimtare, shkurtimisht, duke filluar nga ankimuesi.

Z. I. Sefa: Edhe nga debati që u bë në këtë seancë ka shumë hamendësime që legjislatori e ka thënë këtë, por ka nënkuptuar atë, do të thotë se edhe këtu ku e ka te formulari, kur është bërë formulari në bazë të ligjit është vendimi me burgim, por masa e dënimit është 40 orë. Ligji është i qartë, procedura është e qartë dispozitat janë të qarta. Sot për efektet e ligjit merret vetëm dënimi kryesor, ato të tjerat nuk i konsideroj fare. Madje nuk e konsideron amnistinë, depenalizmin e veprës, nuk e lejon fare asnjë gjë tjetër, as depenalizmin e veprës. Pra, edhe po të hiqet një vepër penale që ka qenë vepër penale atëherë prapë nuk e quan fare, legjislatori thotë sa je dënuar. Te formulari i dekriminalizimit përcaktohet, prandaj thuhet sa është me vendim të formës së prerë sa është masa e dënimit me burgim, e cilëson legjislatori. Pra, e përcakton qartë që duhet të përcaktosh masën e dënimit me burgim, jo sa je dënuar në fund pas pezullimit gjyqimit të shkurtuar e të gjitha me radhë. Se të ishte ashtu do të thoshte sa je dënuar në fund dhe e zgjidhim, ose jep vetëm numrin e dënimit se e shohim vetë thuhet. Ai e ka përcaktuar fare qartë për të bërë check- un fillestar institucioni përgjegjës që e ka për detyrë. Tjetra, zotëria përsëri, se e pashë që ishte shqetësim kjo, përsëri ka deklaruar një të dhënë jo të saktë. Me datën 27 thotë, vendim i formës së prerë numër 11, datë 2.2.2023, ndërkohë që vendimi formës së prerë është më datën 29. Edhe këtë fakt e deklaroi në mënyrë jo të vërtetë. Gjithashtu, siç nuk duhet të përsëritet, t'ju ha kohë më të vyer se ç' është e nevojshme ne mendojmë që ky kandidat është në kushtet e ndalimit. Edhe ky i Komisionerit është precedent i rrezikshëm. Unë e dëgjova me vëmendje edhe palën e përfaqësuese të Partisë Socialiste, që thotë se për vepra të rënda trafikim e të tjera.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Po ka edhe një shkronjë “ç” ligji, thotë i dënuar për vepra me dashje me dënim me 6 muaj burgim, jo më pak se 6 muaj burgim, ndjesë, që është rasti konkret. Çfarë thotë vendimi numër 11 i gjykatës? Është kryer vepër penale me dashje direkte, që është forma më e rëndë e dashjes. Thotë vetë vendimi i gjykatës, që vepra është me dashje, është dënuar 6 muaj. Legjislatori, nëse ka dashur vetëm këta për krim të organizuar dhe trafikime nuk do të vinte këtë dispozitë, apo jo? Këtë shkronjën “ç” nuk kishte pse ta shtonte, se zgjatet ligji dhe bëhet më pak i kuptueshëm. Po ai ka dashur ta shtojë, ka dashur ta përcaktojë si periudhë ndalimi, si dënim që ndalohet. Ndaj, unë mendoj që ky kandidat është në kushtet e ndalimit. Partia Demokratike kërkon nga ana e KAS-it të shfuqizojë vendimin e Komisionerit, të ndalojë kandidimin për kryetar të Bashkisë së Mallakastrës zotin Qerim Ismail, Ismailaj, i cili është në kushtet e ndalimit të përcaktuara në ligjin 138 të vitit 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen dhe emërohen dhe ushtrojnë funksione publike. Që në emër ky ligj është për garantimin e integritetit.

Z. E. Çefa: Avokat jemi në konkluzione.

Z. I. Sefa: I qëndrojmë ankimimit, kërkojmë shfuqizimin e vendimit të Komisionerit nr. 366, datë 15.04.2023 dhe ndalimin e kandidimit të kandidatit për kryetar bashkie të Mallakastrës zotin Qerim Ismail Ismailaj, propozuar nga Partia socialiste e Shqipërisë.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Përfaqësuesi i Komisionerit, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, çfarë kërkon në përfundim, ju lutem?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Ne kërkojmë lënien në fuqi të vendimit nr. 366, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Socialiste?

Z. E. Saliانji: Siç është parashtruar edhe në vendimin e Komisionerit, siç doli dhe nga ky shqyrtim administrativ të kuadrit gjyqësor, del që kandidimi i zotit Qerim Ismailaj është konfrom ligjit dhe nuk parashikohet dënimi i marrë nga ai si kusht për ndalimin e kandidimit, ai lloj dënimi. Sa më sipër kërkojmë lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit duke rrëzuar ankimin.

Z. E. Çefa: Avokati i zotit Ismailaj.

Z. A. Skënderi: Faleminderit! Është i njëjti qëndrim për të mos rënë në përsëritje, duke qenë se mendoj që pyetjet i dhanë kuptim hetimit administrativ nga ana juaj dhe nxorën konkretisht qëllimin e dispozitave në raport me çështjen objekt të hetimit administrativ. Kështu që kërkojmë lënien në fuqi të atij vendimi.

Z. E. Çefa: Faleminderit! KAS-i do të tërhiqet për vendim, do të na duhet një 15 minutësh, maksimumi 20 minuta kohë. Do t'ju ftojme pastaj për të asistuar në shpalljen e vendimit.

Rifillon

Ora:14.45

Z. E. Çefa: Rifillojmë seancën për shpalljen e vendimit lidhur me kërkesën ankimore nr. 49. KAS-i, pasi e diskutoi çështjen në tërësi, me shumicën e votave vendosi:

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Rrëzimin e ankimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Lënien në fuqi të vendimit nr. 366, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Ndaj këtij vendimi palët mund të shtrojnë ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur. Faleminderit të gjithëve!

Vendimi nr. 60

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



19.04.2023
Ora 16:42

RENDI I DITËS

“Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 50, subjekti ankues Partia Demokratike e Shqipërisë”

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **PARTI POLITIKE:** BF, PD

Z. K. Bele: Përshëndetje! Deklarojmë të hapur seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore numër 50, të depozituar më datë 17.03.2023, nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr. 361, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për këshillin e Bashkisë së Tiranës për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore më datë 14 maj 2023; shfuqizimin i vendimit nr. 362, datë 15.04.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtarë për këshillat bashkiakë për 60 bashki për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj të vitit 2023; ndryshimin e përmbajtjes së fletës së votimit duke vendosur kërkesat e përcaktuara në nenin 98, pika 3 e Kodit Zgjedhor, sipas propozimit të bashkëlidhur. Sipas shortit të hedhur, relator i kësaj çështje jam zgjedhur, unë Koli Bele. Verifikojmë pjesëmarrjen. KAS-i është i pranishëm me 5 anëtarët e tij. Për ankuesin?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Indrit Sefa: Indrit Sefa, prezent.

Z. K. Bele: A ka palë të interesuara të pranishme?

Z. A. Kaziaj: Nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”, Altin Kaziaj.

Franci Nuri: Franci Nuri, prezent.

Z. K. Bele: Të pranishëm sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së. Legjitimi i palëve është zgjidhur në seancë paraprake. A ka ndonjë kërkesë paraprake në lidhje me anëtarët e KAS-it apo kompetencën? Nuk kemi në këtë fazë. Vazhdojmë me themelin e çështjes. Sekretari i Përgjithshëm do të bëjë një parashtrësë të shkurtër ku jemi me këtë fazë.

Z. A. Kaziaj: Kam një kërkesë paraprake tjetër, jo me formimin e trupës, nëse ma lejon relatori.

Z. K. Bele: Po.

Z. A. Kaziaj: Pak më parë është depozituar pranë këtij institucioni një shkresë me lëndën njoftim, që ka lidhje edhe me shqyrtimin administrativ të këtij ankimi, të vënë në lëvizje nga kolegu Sefa, mban numrin e protokollit 3968, datë 19.04.2023. Besoj se anëtarët e KAS-it kanë dijeni për shkresën, sepse kanë edhe kopje të sajë, kështu që të merret parasysh përmbajtja e shkresës si vullnet i qartë i partive pjesëtare të koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. K. Bele: Ky është një kërkim i juaji, i cili mund të paraqitet në këtë fazë ose edhe gjatë shqyrtimit, sepse shkresa, me sa shikojmë në pamje të parë, ka të bëjë me një kërkim tuajin, kështu që si në këtë fazë si më vonë ne nuk mund të bëjmë gjë tjetër veçse ta administrojmë dhe do të shqyrtohet në tërësi me provat e tjera gjatë procesit. Më fal, Ylli, meqenëse jemi në seancë themeli mund të dëgjojmë një herë kërkuesin, pastaj qëndrimin tuaj për t'i dhënë rrjedhshmëri logjike procesit. Po, zoti Sefa, ju lutem.

Z. I. Sefa: Po, i nderuar relator, të nderuar anëtarë, jeni njohur me anikimin, nuk dua që t'ju marr kohë të vyer duke e lexuar dhe relatuar të tërin, por të themi vetëm argumentet kryesore ku e mbështesim të gjithë kërkimin tonë. Komisioneri, siç jeni në dijeni, më datë 15.04.2023 ka miratuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatë anëtarë të këshillit bashkiak për Bashkinë e Tiranës, si edhe për 60 bashki të tjera, me dy vendime të ndryshme, vendimet numër 361 dhe 362. Kjo vendimmarrje ka qenë e debatuar gjerësisht në seancë publike dhe të gjitha argumentet i janë paraqitur edhe Komisionerit, i cili, në mënyrë të pashpjegueshme, ka mbajtur një qëndrim për mendimin tonë në kundërshtim me ligjin dhe përcaktimet e Kodit Zgjedhor dhe më konkretisht nenin 98, pika 3, gjithashtu, edhe në nenin 65, pika 3 të Kodit Zgjedhor, si përcaktime fare të qarta në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit. Gjithashtu, kemi referuar që për këtë çështje ka edhe një vendim të KAS-it që ne e kemi referuar dhe është ai me numër 19, datë 03.04.2021 dhe vendim Kolegji me numër 5, datë 04.04.2021. Këto janë vendimmarrje, të cilat janë të njohura për organin e KAS-it dhe janë vendimmarrje që kanë trajtuar në themel që në vitin 2021 përmbajtjen që duhet të ketë fleta e votimit. Më konkretisht KAS-i e argumenton në mënyrë të shpjeguar faktin se çfarë


*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

duhet të përmbajë fleta e votimit dhe po e referoj në mënyrë të përmbledhur. Pra, KAS-i në vendimmarrjen numër 19 të tij thotë: Por Kodi bashkë me diskrecionin i ka caktuar KQZ-së kufij të pakapërcyeshëm dhe të palëvizshëm. Këto kufij kanë të bëjnë me: fleta e votimit duhet të jetë me ngjyrë format e të gjitha me radhë dhe gjithashtu, thotë: Emrat e subjekteve zgjedhore duhet të vendosen në fletën e votimit sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Nenin 98, pika 3. Pra, KAS-i i thotë Komisionerit që ti ke liri për të bërë fletën e votimit në përmasa dhe në tipin e llojit, por, gjithsesi, ka disa kufij që do t'i respektosh, dhe një nga këto kufij është përcaktimi i siglës, logos në këtë rast, shkronjën nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Por më tej kolegji ka qenë pak më i detajuar. Në vendimin nr. 5 datë 04.04.2021 Kolegji thotë (po citoj vetëm pjesën që na intereson) Kolegji vë në dukje se i njëjti rregull vlen edhe kur subjekti zgjedhor është koalicion, i cili, kur regjistrohet, në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, duhet të deklarojë partinë udhëheqëse të tij, e cila për nevojat e zbatimit të këtij Kodi përmbush të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton Kodi për subjektet zgjedhore. Dhe këtë referon me paragrafin, ku thotë që, për sa i përket pretendimit të paditësit për paligjshmëri të vendimit nr. 19 KAS-i, në lidhje me logon e partisë Bindja, në atë rast, ka miratuar duke pasqyruar fletën e votimit. Kolegji thekson se është i bazuar nenin 93, pika 3 e Kodit Zgjedhor, parashikon ndër të tjera se në fletën e votimit përbri emrit ët partisë vendoset sigla, pra, logo, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Kolegji thotë që edhe kur është koalicion duhet vendosur. Ne kemi vendimmarrje, siç jeni në dijeni, në vitin 2021 ka qenë Kolegji që bashkë me KAS-in dhe Komisionerin kanë hartuar këtë fletë votimi. Fleta e votimit e viti 2021, koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, PDAN, kryetar Lulzim Basha, koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor, ABOK, kryetar Kujtim Gjuzi. Kjo është praktika e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Komisionerit. Nuk e ka kundërshtuar asnjë njeri këtë, as ato parti që sot janë në një koalicion të ri. Cili është propozimi me të cilin vjen sot Komisioneri, që çuditërisht nuk e gjej të pasqyruar në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor? Sot është në dorë të koalicionit, thotë, e mendon kështu, thotë, po deshi e vendos po deshi nuk e vendos. Tani nuk ka ligj me zgjedhje, ose zbatohet, ose nuk zbatohet. Kur hartohet një ligj, një dispozitë ligjore është për t'u zbatuar dhe nuk mbetet në dëshirën e atij që duhet ta zbatojë, ose është për t'u zbatuar, ose nuk është për t'u zbatuar. Komisioneri e interpreton një herë e interpreton ligjin në frymë, një herë në germë, një herë në hapësirë, një herë në ajër. Tani, çfarë krijon tjetër kjo? Nëse të gjitha subjektet zgjedhore janë me emër dhe kryetar partie, si ka mundësi që dy subjekte dalin pa kryetar partie? Tani ose janë subjektet e barabarta përpara ligjit, ose nuk janë, pra ose duhet të jenë dhe të trajtohem njësoj përpara ligjit, ose nuk duhet të jemi në trajtim të barabartë para ligjit. Kjo nuk mund të përcaktojë, kjo nuk mund të jetë mënyra si e pasqyron veprimtarinë e tij një organ publik. Gjithashtu, kemi edhe një fakt shumë interesant, ju jeni të familjarizuar me logon e Partisë Demokratike, por ky koalicion i ri ka një logo tjetër. Tani, ku është Partia Demokratike në koalicion pjesë e këtij koalicionit? Çdo logo e Partisë Demokratike të jetë pjesë e fushatës zgjedhore të subjekteve të tjera zgjedhore.

Z. K. Bele: Këtu po flasim për fletën, zoti relator, nuk po flasim për tubimet publike. I më të bëhet ankesë të Komisioneri dhe sipas ligjit...

(Diskutime pa mikrofon)

Z. I. Sefa: Po fokusohem te fleta për të shpjeguar që e gjithë kjo vendimmarrje e Komisionerit ka qenë e qëllimshme në konceptin tonë për të krijuar diferencim në

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina, LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

mes subjekteve zgjedhore. Në vendimmarrje Komisioneri nuk ka asnjë dispozitë së cilës i referohet për vendimmarrjen tij. Ai thotë që si Komisioner mora këtë vendimmarrje që t'ia lëmë në dëshirë subjektit të vendosë emrin ose të mos e vendosë emrin e kryetarit udhëheqës të partisë të koalicionit, por nuk ka asnjë dispozitë ligjore se ku thotë që kjo vendimmarrja juaj bazohet në këtë dispozitë.

Z. K. Bele: Më falni, se nuk dua të bëj debat, jeni duke bërë parashtrimin, vendimi i Komisionerit ka një bazë ligjore, dhe ju mund t'i referoheni asaj baze ligjore duke e prapësuar ose mund të mos bini dakord me atë, por vendimi i Komisionerit ka një parashtrësë, ka një shpjegim, ka një bazë ligjore, ka një dispozitë. Pra, të fokusohemi që të mos hyjmë të mos bëjmë figura letrare.

Z. I. Sefa: Jo nuk e kam aty unë, mbase u keqkuptova.

Z. K. Bele: Po çfarë nuk je dakord me bazën ligjore?

Z. I. Sefa: Nuk ka bazë ligjore me të cilën të mbështesë vendimmarrjen e tij, por i referohet nenit 98.

Z. L. Braho: Te cila pjesë te vendimi i Komisionerit është kjo e zgjedhjes?

Z. I. Sefa: Nuk ka në asnjë vend, pra e ka thënë në seancë publike.

Z. L. Braho: A është thënë në seancë publike.

Z. I. Sefa: E kam lënë tha, madje u shty edhe seanca se tha pyesni partitë.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LËKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, se është anë procedurale.

Z. K. Bele: Na ndihmon ne.

(Diskutime pa mikrofon)

Më lër të mbaroj! Ne jemi seancë publike dhe është në interes edhe të ecurisë publike dhe është në interes edhe të ecurisë së procesit që të shpjegojmë se çfarë kundërshtojmë, sepse nëse ju doni të sillni një element, i cili lidhet me diskutimet që janë bërë në ato mund t'i citoni nga procesverbali, nëse e keni ose jo, por, kur të flasim për vendimin, t'i referohemi vendimit, dhe të jemi racionalë se në hyrje thatë që unë do të flas shkurt.

Z. I. Sefa: Ju kërkoj ndjesë do të them diçka dhe e mbylla, se doja ta bëja në formë debati më saktësisht. Komisioneri e ka shtyrë vendimmarrjen për fletën e votimit, sepse po të shikoni edhe procesverbalin e seancës ka thënë që t'i lëmë kohë partive politike, subjekteve që janë në koalicion të propozojnë emër ose jo, të shprehin interesin, duan apo nuk duan të vendosin emër. U shty një orë, në mos gabo, por pas një ore tha se subjektet nuk duan të vendosin emër dhe unë nuk po vendos emër. Gjithashtu, u ngrit edhe një pretendim që kjo ka qenë praktikë e ndjekur në vitin 2021, ndërkohë që subjekti zgjedhor, Partia Demokratike, që ka qenë pjesë e një koalicioni në vitin 2021, nuk e di që mund të ketë ekzistuar një praktikë e tillë, ose të ketë dërguar një shkresë të tillë për të thënë që ne e kryetarit. Gjithashtu,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LËKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

argumentet janë në ankim. Ju besoj se jeni njohur me ankimin dhe të mos zgjatem më tej. Faleminderit!

Z. A. Kaziaj: Faleminderit! Qëllimi i bërjes së këtij ankimi nga ana e kolegut parafolës është se sjell konfuzion te zgjedhësit, të paktën kështu tha. Nuk e di se çfarë konfuzioni mund të vijë te zgjedhësit? Cila është në kundërshtim me atë që ligjvënësi ka parashikuar nenin 66 ku thuhet se nëse dy parti politike ose koalicioni kanë emër ose emblemë të njëjtë ose të ngjashme në atë masë sa që mund të shkaktojnë konfuzion ose lajthitje te votuesit atëherë KQZ-ja vendos sipas parashikimeve. Tani ky ishte në vetvete objekti i vënies në lëvizje të këtij komisioni nëpërmjet kundërshtimit të një vendimi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pra, nuk na shpjegoi në parashtrimet e veta, se cili është në këtë rast konfuzioni që sjell te zgjedhësit dhe se cili është disavantazhi i partisë që ai përfaqëson në raport me pasjen ose mospasjen e emrit të një koalicioni, të themi të personit ose të personit përgjegjës për drejtimin e koalicionit ose të një personi sipas parashikimeve të një marrëveshjeje të përcaktuar kjo në pikën e tretë të nenit 65. Pra, cili është konfuzioni? Cili është trajtimi ndryshe i partisë ankuese pranë këtij komisioni? Këto gjëra nuk i mora vesh, nëse do të ndërhyjë kolegu dhe do të na sqarojë në lidhje me këtë, do të isha shumë mirënjohës. Pra, edhe në fillim të fjalës sime unë vura në dukje që pranë jush është dorëzuar një shkresë komunikuese për të hequr për të hequr të gjitha ato që janë dyshimet, interpretimet, keqinterpretimet, qëllimshmëria e disa veprimeve të caktuara. Koalicioni ka vendosur që, pavarësisht se ju e dini fare mirë dhe keni qenë edhe ju vendimmarrës të një procedure quazi ekstra ligjore, në këndvështrimin tonë, sa i përket pjesës së caktimit të partisë politike një personi që nuk është kryetar, ndërkohë që vetë neni 64 parashikon dokumentacion të qartë, siç është dhe vendimi gjykatës, në këtë rast gjykatës së Tiranës që mban regjistrin e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*


partive politike, vendimi nëpërmjet të cilit vërtetohet fakti i pasjes i qenies së një kryetari dhe emri i kryetarit të partisë. Ndërkohë që ju, në një mënyrë të pashpjegueshme, në këndvështrimin tim caktuat shtetasin Alibeaj si kryetar të partisë pa pasur një vërtetim që është një dokumentacion imponues nga ligji zgjedhur, e caktuar kryetar të partisë. Edhe në vazhdë të këtij arsyetimi të bërë nga ana juaj, duke qenë se keni mbajtur qëndrime të kësaj natyre, duke qenë se ligji nuk na imponon që ne të vëmë emrin e një personi që dëshiron zoti Sefa, që ka bërë dhe kopjet e fletës së votimit, dhe ia ka shpërndarë edhe gazetarëve, duke i shënuar edhe emrin që do zoti Sefa, nuk e di, ka ndonjë lidhje të veçantë me të mesa duket, po ndërkohë që vendoset nga anëtarët, nga partitë përbërëse të koalicionit, se cili do të jetë personi që, sipas nesh, duhet të jetë në fletën e votimit. Kështu që në brendësi të shkresës keni çdo specifikim të vullnetit të dhënë nga përfaqësuesi i koalicionit për deputetin Sali Berisha, i cili me marrëveshje të bërë të koalicionit duam që të rezultojnë në fletën e votimit në numrin 1 të saj sipas shortit të bërë ditë më parë. Faleminderit.

Z. F. Nuri: Një plotësim, të lutem.

Z. K. Bele: Nuk ka asnjë.

Z. F. Nuri: Po faleminderit. Pa dashur të bëj avokatinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sepse mbrojtjen ndaj tij do ta bëj patjetër sekretari i Përgjithshëm i KQZ, thjesht mora shkas nga ajo çfarë tha kolegu Sefa se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve herë e ka interpretuar Kodin në frymë e herë në germë dhe unë në gjykimin tim shoh 3 shembuj ku Komisioneri, qoftë dhe publikisht, qoftë dhe me vendime, e ka interpretuar, në fakt, Kodin Zgjedhorë në germë. Do t'ju jap

*Zbardhi materialin audio
Mirgjinda LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

shkurtimisht këto shembuj se për analogji lidhen dhe me rastin tonë. Shembulli parë është neni 64 i Kodit Zgjedhorë, regjistrimi i partive politike ku Komisioneri mbajti qëndrimin strikt duke i qëndruar Kodit Zgjedhor se për regjistrimin, për analogji...

Z. K. Bele: Më fal, se nuk ju pengoj të bëni argumentin tuaj, por keni parasysh që nuk jemi mbledhur të bëjmë analizë as të Komisionerit as të KAS-it.

Z. F. Nuri: Nuk do të merrem më shumë se 30 sekonda

Z. K. Bele: Do të rrimë tek objekti i shqyrtimit

Z. F. Nuri: Patjetër aty do të dilja i nderuar, me analogji aty do të dal. Pika e parë e nenit 64 ku Komisioneri i qëndroj strikt Kodit Zgjedhor duke thënë se dua emrin tek fleta e regjistrimit të partive politike, pika e dytë, në gjykimin tim, është neni 91 ku ka një ngjashmëri mjaft interesante me nenin 65 për koalicionet. Pse? Sepse Komisioneri në një shprehje publike, i pyetur dhe nga mediati, është shprehur se në lidhje me ndalimin e përdorimit të fondeve publike në fushatat për zgjedhjet vendore, ai është shprehur publikisht se germa e ligjit, neni 91, Kodi Zgjedhor nuk parashikon që këto të zbatohen për zgjedhjet vendore, sepse, në një pikë, pika 3 apo 4 e asaj dispozite nuk parashikohet apo bëhet një përjashtim për zgjedhjet vendore, duke thënë se ajo ndalesë për përdorimin e fondeve zbatohet vetëm për zgjedhjet e përgjithshme. Argumenti i 3 është se në nenin 65 Komisioneri, në gjykimin tonë, për regjistrimin e koalicioneve në rastin konkret e ka lexuar Kodin Zgjedhor në germë. Pikërisht në nenin 65, më falni neni 98, përmbajtja e fletës së votimit, pika 3 ku flitet për bri emrin të partisë politike vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë, në asnjë vend në këtë dispozitë nuk parashikohet që të jetë për bri emrit të

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina JLEKAJ*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023**

koalicionit, por Kodi Zgjedhor, mund të jetë lapsus apo mund të jetë harresë, kjo është tjetër punë, ka parashikuar vetëm partinë, përbri partisë. E njëjta gjë është edhe në nenin 91 ku thuhet se 4 muaj nga data e zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë nuk lejohet rritje pensionesh, pagash etj., Dhe Komisioneri ka thënë se nuk ka shkelje, sepse është për rastin e zgjedhjeve të përgjithshme ajo lloj ndalese, nuk është për rastet e zgjedhjeve vendore. Pra, edhe një herë ne gjykojmë që pikërisht këtu, neni 98, pika 3, duhet të zbatohet në germë Kodin Zgjedhor dhe fatkeqësisht Kodi Zgjedhor, i hartuar në këtë mënyrë, me amendimet e tij të fundit të vitit 2020, nuk e ka parashikuar që të jetë me detyrim që koalicioni të ketë siglën apo kryetarin e partisë, por këtë gjë e ka lënë vetëm për partinë politike. Kështu që në gjykimin tonë, nuk ka vend për interpretime të tjera, është koalicioni ai që vendos në mënyrë të lirë me marrëveshjen midis partive pjesëtare të koalicionit, sikurse kjo parashikohet në nenin 65, pika 3, të Kodit Zgjedhor, ku thuhet që marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen me marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet. Pra, në gjykimin tonë janë partitë pjesë e koalicionit “Bashkë Fitojmë” ato që kanë të drejtën, duan apo nuk duan të përfaqësohen me një emër kryetari partie, e kanë ato plotësisht të drejtën, kjo nuk ka pse t’i prishë punë dikujt tjetër. Fakti që ne si koalicion nuk duam të kemi emër kryetari, është e drejta e anëtarit të koalicionit dhe kjo nuk ka sens që të vijë dikush tjetër, një subjekt tjetër e të thotë, jo, ti duhet të vësh patjetër një emër kryetari. Nuk bën sens. Meqenëse, siç e përmendi edhe kolegu Kaziaj, në këto kushte ku jemi ndodhur, ku *de facto* e *de juro* po kërkohet të na imponohet nga subjektet e tjera një emër i caktuar në fletën e votimit, atëherë koalicioni ka marrë vendim, në mënyrë të ligjshme, me vullnet të lirë dhe të plotë, fleta është e nënshkruar nga përfaqësuesi i koalicionit, që në marrëveshjen e koalicionit, zoti Brahimllari, i ka të gjitha tagrat e përfaqësimit të të tri subjekteve

**Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023**

pjesë e koalicionit dhe shkresa konfirmon vullnetin e plotë, të lirë të koalicionit “Bashkë Fitojmë” që në fletën e votimit të paraqitet me deputetin Sali Berisha. Faleminderit!

Z. A. Kaziaj: Edhe një gjë të vogël, pa iu marrë shumë kohë, zoti Bele. Fakti është që fleta e votimit, pavarësisht që jemi në një ankim pranë këtij Komisioni, është bërë renditja e posaçme sipas atyre që ishte rezultati i shortit. Në numrin 9 të saj, nëse nuk gaboj, është Partia Demokratike. Rezulton përbri emrit të saj, të paktën nga ai që është model i bërë nga Komisioneri, zoti Alibeaj, ndërkohë që ju e dini shumë mirë që zoti Alibeaj nuk është kryetar partie dhe bie në kundërshtim me frymën, në qoftë se do të zbatohet frymën e nenit 98, pika 3, në qoftë se e shohim *striptum sensum*, siç e keni parë në atë rast ju, sipas meje edhe për analogji me atë që janë kërkesat tona. Vërtet zoti Berisha nuk është kryetar i ndonjë partie në këtë rast, por është deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, është pjesë përbërëse e koalicionit si deputet i Kuvendit, ndaj është vullnet yni që në numrin 1 të fletës së votimit të rezultojë emri i zotit Sali Berisha, edhe për atë që ju thashë pak më parë, Faleminderit!

Z. K. Bele: Faleminderit! Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 15.4.2023 ka marrë në shqyrtim vendimet nr. 361 dhe nr. 362, ku ka miratuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët e këshillit të Bashkisë Tiranë dhe 60 bashkive të tjera në rang vendi. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri ka vendosur miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatë për anëtarë të këshillit të bashkisë dhe të 6 bashkive të tjera. Në arsyetimin e tij Komisioneri është mbështetur në nenin 98,

**Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

pikat 3 dhe 4, të Kodit Zgjedhor, ku thuhet që emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Duke qenë se në fletën e votimit kanë qenë dy koalicione dhe Kodi Zgjedhor, konkretisht neni 98, pika 3, nuk e parashikon shprehimisht që përbri emrit të koalicionit duhet të vendoset edhe emri i kryetarit të koalicionit, Komisioneri ka arsyetuar që...(nuk dëgjohet), nuk dihet se kush ishte emri i kryetarit të partisë, nuk e ka përcaktuar Kodi, dhe e ka lënë bosh emrin e koalicionit. Faleminderit!

Z. K. Bele: Unë kisha një pyetje që po e bëj për tre. Po, zoti Sefa.

Z. I. Sefa: Të njihem pak me kërkesën?


(Diskutime pa mikrofon)

Z. A. Kaziaj: Pse e vendosni ju? E bën KQZ-ja këtë punë, administrata.

Z. I. Sefa: Mund të mbaj qëndrim?

Z. K. Bele: Nuk kemi arritur te diskutimi. Unë kam një pyetje, po e filloj nga Ylli, meqë ishte i fundit, por jo për nga rëndësia. Neni 65, që u citua nga palët, pika 3 u citua edhe ju, si e kuptoni, po e marr me radhë, në emër të KQZ-së, "Për nevoja të zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore, përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit". Ylli, mendon që partia përmbush detyrimet që do të duhet të përmbushte sikundër të ishte vetëm parti, pra partisë në emër të koalicionit deri ku i shkojnë detyrimet që përmbushen nga ajo?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Mendoj që partitë e koalicionit kanë lidhur një marrëveshje midis tyre, ku rregullojnë të gjithë të drejtat dhe detyrimet, caktojnë edhe partinë udhëheqëse të koalicionit, por...

Z. K. Bele: Duke pasur gjithmonë parasysh që Partia e Lirisë është partia...

Z. Y. Merkaj: Neni 65, pika3, nuk parashikon që partia udhëheqëse e koalicionit duhet të vendosë edhe kryetarin e saj dhe përfaqëson koalicionin kryetari i partisë udhëheqëse. Thjesht e ka kërkuar që të ishte i përcaktuar shprehimisht në Kod që në fletën e votimit partia udhëheqëse e koalicionit duhet të përfaqësohet me kryetarin për gjithë koalicionin te fleta e votimit. Nuk është parashikuar është menduar që ka një boshllëk aty.

Z. K. Bele: Po në vitin 2021 ose në vitet e mëparshme kur ka qenë emri i kryetarit të koalicionit? Në dijeninë tuaj.

Z. Y. Merkaj: Ideja ka qenë që kanë qenë në marrëveshje ose të gjitha partitë kanë kërkuar të vendoset emri.

Z. K. Bele: Pra, është kërkuar në marrëveshjen e koalicionit në vitin 2021 që të vendoset emri në fletën e votimit?

Z. Y. Merkaj: Është kërkuar.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjitna LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. K. Bele: Ju lutem, nëse mund të na e gjeni atë marrëveshjen e koalicionit nga administrata do të na ndihmonte. Zoti Sefa, pyetja është e njëjtë.


Z. I. Sefa: Në bazë të ligjit, nenit 65, pika 3, është totalisht i qartë dhe ky është një ndryshim që ka ndodhur me ndryshimet e Kodit Zgjedhor në vitin 2020. Edhe marrëveshja si koncept koalicioni ka hyrë në vitin 2020, siç jeni në dijeni që u bë ndryshimi që nuk ka më koalicioni, garoni si subjekte brenda koalicionit, por duhet të ishte një koalicion i përbërë. Marrëveshja ka lindur aty. Legjislatori ka qenë i kujdesshëm ku thotë që të gjitha të drejtat dhe detyrimet i merr partia udhëheqëse e koalicionit, prandaj edhe marrëveshja ka detyrimisht një parti udhëheqëse të koalicionit, e detyron marrëveshja.

Z. K. Bele: Deri në çfarë faze?

Z. I. Sefa: Që në momentin e regjistrimit të koalicionit në marrëveshje bëhet e qartë. Në marrëveshjen midis partive politike, partia drejtuese e koalicionit është ky subjekt zgjedhor. Edhe ligji e thotë që duhet të regjistrohen një herë si subjekte zgjedhore, pastaj të bëjnë koalicione dhe në koalicione është përcaktuar fare qartë që koalicioni ka parti udhëheqëse dhe të gjitha të drejta e detyrimet i merr ajo. Në bazë të nenit 98, pika 3, është detyruese vendosja e emrit të kryetarit në fletën e votimit. Kjo është e qartë. Emri i kryetarit duhet të jetë në fletën e votimit. Po t'i referohemi përsëri nenit 65, thotë që ky detyrim që e ka subjekti si subjekt, i kalon subjektit drejtues të koalicionit dhe duhet të vendoset emri i kryetarit të partisë drejtuese të koalicionit.

Z. K. Bele: Po, zoti Kaziaj.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. A. Kaziaj: Është e njëjta pyetje edhe për ne? Për të riformuluar të paktën sipas këndvështrimit tim të pikës 3 të nenit 65 se cila ka qenë fryma e ligjvënësit sipas leximit tim që i bëj normës. Ai paragraf që ju lexuat, nuk ka të bëjë në vetvete me cedimin e detyrimeve që partia udhëheqëse e koalicionit ka kundrejt një personi tjetër në këtë rast, nuk cedohet asnjë detyrim. Të gjitha detyrimet i ka Partia e Lirisë, sipas ligjit. Vënia e emrit të një personi të caktuar me marrëveshje, të një deputeti të Republikës së Shqipërisë, nuk shoh ndalim në asnjë vend që ligjvënësi shprehimisht ta ketë vënë. Pra, flitet për detyrime të partisë udhëheqëse, që përmbushen nga partia udhëheqëse. Kjo për të facilituar pak, se mund të jenë 10 parti që formojnë një koalicion, për të facilituar edhe qasjen ose marrëdhënien që mund të kenë këto 10 parti të koalicionit edhe me këtë institucion, se t'i drejtohen të gjitha partitë këtij institucioni, i bie që do të kemi një mbingarkesë, prandaj ligjvënësi e ka parashikuar si të tillë, të zgjidhet një parti nga dy ose më shumë parti përbërëse të koalicionit, por kjo nuk do të thotë që cedimi i detyrimeve që ligjvënësi ka parashikuar t'i lihen një personi që nuk është i partisë. Absolutisht jo, nuk flitet për kryetarin, flitet për partinë në përgjithësi.

Z. K. Bele: Po.

Z. F. Nuri: Unë sqarimin tim në lidhje me këtë pjesë doja ta bëja në formë pyetjesh, pse jo me Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së, nëse më lejohet. Në marrëveshjen aktuale të depozituar a është përcaktuar nga koalicioni emri që do të përfshihet në fletën e votimit?

Z. K. Bele: Ju e keni marrëveshjen, se është marrëveshja juaj.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. F. Nuri: Na e konfirmon që nuk është.

Z. Y. Merkaç: E konfirmoj.

Z. K. Belev: Ju jeni hartuesit.

Z. F. Nuri: Edhe një pyetje tjetër, se kjo ishte pyetje retorike. A është detyrim ligjor, sipas qëndrimit të KQZ-së, që në marrëveshjen midis koalicionit të përfshihet detyrimisht edhe emri që do të figurojë në fletën e votimit të koalicionit?

Z. K. Belev: Nëse unë nuk marr përsipër t'i përgjigjem, por përfaqësuesi i KQZ-së e mbajti qëndrimin që kjo nuk është detyruese. Unë thjesht e pyeta si e lexon detyrimin që buron nga ligji, pra, neni 65 flet për mbajtjen e detyrimeve të partisë udhëheqëse të koalicionit. Ne mund të lexojmë në mënyra të ndryshme siç ju të dyja palët në këtë debat e lexuat në mënyra të ndryshme. Dhe unë doja të dëgjoja përfaqësuesin e KQZ-së. Për paritetet jua shtrova edhe juve të njëjtën pyetje, por ju ndërkaq e keni mbajtur qëndrimin tuaj dhe ne nuk do të biem në përsëritje. E kam për ju që sollët marrëveshjen, por mund të shprehen edhe palët, debati bëhet. Keni sjellë edhe njoftimin, që mund ta quani edhe kërkesë, nuk kam problem me këtë, por shoh që në emër të koalicionit "Bashkë Fitojmë" dhe partive përbërëse informojmë për efekt pasqyrimin korrekt të të dhënave në fletën e votimit sipas parashikimit të nenit 98 të Kodit Zgjedhor si drejtues i koalicionit është deputeti Sali Berisha. Përfaqësuesi i koalicionit, firmosur nga zoti Endrit Brahimllari. Unë po lexoj te koalicioni, pika 5, tagrat që zoti Brahimllari ka: të paraqesë kërkesë për regjistrimin e koalicionit bashkë me marrëveshjen; të përfaqësojë koalicionin sipas procedurave, shortit në

*Zbardhi materialin audio
Mirgjinë LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

KQZ për renditjen e subjekteve; vëzhguesit të përfaqësojnë koalicionin; të autorizojë përfaqësues të tjerë për ta përfaqësuar atë në KQZ, në instanca të tjera administrative gjyqësore, kur të konsiderohet e nevojshme. Nuk e kuptoj nga buron kjo e drejtë e zotit Brahimllari?

Z. A. Kaziaj: E drejta buron nga vullneti i palës, që është në këtë rast Partia e Lirisë, që është dhe vetë palë firmëtare, duke qenë se nuk është kundërshtuar nga asnjë prej dy partive të tjera që përbëjnë koalicionin dhe nga asnjë palë e interesuar. Kjo e drejtë është një e drejtë që ai e ka ushtruar sipas marrëveshjes së bërë nga koalicioni. Faleminderit!

Z. K. Bele: Po.

Z. I. Sefa: Një pyetje...

Z. K. Bele: Keni gjë për të thënë për këtë?

Z. I. Sefa: Do të mbaj qëndrim për këtë shkresë.

Z. L. Braho: Kam pyetjen për Yllin. Nga zoti Sefa u pretendua që gjatë seancës me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, ai u ka lënë kohë palëve që të vendosin në qoftë se do të caktojë një person, apo jo. E konfirmoni ju këtë?

Z. Y. Merkaç: Siç thashë edhe pak më parë, në praktikën e KQZ-së gjithmonë kur është miratuar fleta e votimit është bërë me konsensus dhe me debat ka kaluar. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Komisioneri në vitin 2021...

*Zbardhi materialin audio
Mirgjitna LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. L. Braho: Flas ekzaktësisht për t'u ofruar përfaqësues koalicioneve.

Z. Y. Merkaj: U la një orë kohë të mendonin. Në qoftë se partitë pjesëmarrëse të koalicionit mundtë binin dakord e mund të vendosnin emrin, nuk i prishte punë...

Z. L. Braho: Kërkesa ekzaktësisht si ishte, për të sjellë një person, apo një kryetar partie?

Z. Y. Merkaj: Bëhet fjalë për kryetarin e partisë.


Z. L. Braho: Cila ishte përgjigjja e koalicionit...

Z. Y. Merkaj: Nuk ranë dakord partitë pjesëmarrëse të përfaqësoheshin me kryetarin e partisë udhëheqëse. Edhe ngeli pa emër. Të dyja koalicionet.

Z. A. Kaziaj: Për koalicionin tjetër pse nuk është bërë ankim, kur kanë mbetur pa emër?

Z. I. Rusmali: Për të freskuar memorien e Yllit. Po citoj nga procesverbali i mbledhjes fjalën e Komisionerit në lidhje me çështjen e vendosjes së emrit ose jo në fletën e votimit të kryetarit të një prej partive përbërëse të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, po e theksoj edhe një herë të kryetarit të një prej partive përbërëse të koalicionit “Bashkë Fitojmë”: “Unë do t’ju jap një orë kohë për të vendosur në lidhje me këtë. Nëse doni apo nuk doni që të jetë emri”. Pra, Komisioneri nuk ka kërkuar

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

kush do të jetë emri, ka dhënë alternativën doni apo nuk doni emër. Kjo është e saktë besoj unë.

Z. A. Kaziaj: Nuk qëndron kjo gjë, pavarësisht...

Z. I. Rusmali: E kishim me Yllin. Ylli dha një prononcim.

Z. A. Kaziaj: Ju e kishit me Yllin lidhur me një qëndrim tuajin që cenon subjektin që unë përfaqësoj. Kështu që do të më jepni të drejtën e fjalës.

Z. I. Rusmali: Kur të mbarojnë pyetjet...

Z. A. Kaziaj: Nuk jemi duke lozur këtu. "Mbyllja pak" nuk mund t'ia thuash relatorit. E drejton ai seancën, jo ju.

Z. K. Bele: Të lutem, një sekondë, të respektojmë njëri-tjetrin. Anëtar i KAS-it lexoi një pjesë nga procesverbali. Nëse keni ndonjë rezervë për përmbajtjen e asaj që lexoi, do të mbani qëndrim.

Z. I. Rusmali: Nuk ishte për ty. Ke të drejtën të flasësh më vonë.

Z. K. Bele: Do mbaroj unë, të jap të drejtën të flasësh sa të duash, por ta dëgjojmë njëri-tjetrin. U lexua një pjesë nga procesverbali, u mbajt një qëndrim. Kërko fjalën dhe mbaj qëndrim, jo debate për çfarë themi. Edhe ne të pestë që jemi në trupë, nuk biem dakord shumicën e kohës. E dëgjojmë njëri-tjetrin me radhë dhe mbajmë qëndrimet tona. Vazhdojmë me pyetje.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjinda LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. L. Braho: Kam pyetje për përfaqësuesit e koalicionit. Çfarë ka ndryshuar nga dita që ka qenë seanca pranë Komisionerit, ku ju dha mundësia për të zgjedhur një përfaqësues deri ditën e sotme që sollët kërkesën?

Z. A. Kaziaj: Thjesht është marrë dakordësia e palëve të tjera që përbëjnë koalicionin dhe kërkesa ka ardhur e unifikuar në qëndrim të të gjitha partive përbërëse të koalicionit lidhur me emrin që i intereson këtij koalicioni të jetë në fletën e votimit. Është shumë e thjeshtë. Kjo ka ndryshuar. Asgjë më tepër.

Z. E. Lako: Kam një pyetje për dy përfaqësuesit e koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Me çfarë po kuptojmë, i gjithë debati ka të bëjë me dy pika kryesore: e para, vendosja e përfaqësuesit të koalicionit në fletën e votimit dhe, e dyta, cili do të jetë emri, apo jo? Për pjesën e parë unë mendoj që është ezauruar pas paraqitjes së këtij njoftimi që na erdhi këtu, që ta sqarojmë këtë. Përderisa edhe relatori bëri një pyetje që çfarë përfaqëson zoti Brahimllari në lidhje me koalicionin, për të qenë edhe ne korrektë, ja ku ju kemi ju dy përfaqësues, ju jeni dakord me këtë qëndrim të zotit Brahimllari si përfaqësuesit e koalicionit në KAS? Pra, jeni dakord që në fletën e votimit do të jetë edhe emri i dikujt?

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, për pyetjen! Fakti është që ju jeni vënë në lëvizje nga ana e kolegut Sefa me ankimin e vet ka kërkuar të vihet një emër, por jo të vihet emri x, se nuk mund ta kërkojë në mënyrë të tillë. Fakti është shumë i thjeshtë. Siç ia thashë edhe zotit Ledio Braho lidhur me dakordësinë që ka tashmë, konkretizuar nëpërmjet kësaj shkrese të gjitha partive pjesëmarrëse në koalicionin “Bashkë Fitojmë”, qëndrimi ynë zyrtar është që konfirmojmë shkresën e zotit Brahimllari,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

mbështesim shkresën e zotit Brahimllari dhe duam, edhe një herë e shprehim, që në numrin 1 të fletës së votimit të jetë i shënuar emri i zotit Sali Berisha. Faleminderit!

Z. F. Nuri: Po, i nderuar, për efekt formal, konfirmoj edhe unë, si përfaqësues i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, dëshirojmë që numri 1 në fletën e votimit të jetë zoti Sali Berisha, si përfaqësues i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, po themi.

Z. E. Lako: Pra, ju e konfirmoni që jeni dakord që në fletën e votimit të ketë emër edhe përfaqësuesi i koalicionit. Tani, unë mendoj që debati mund të kalojë te pjesa e dytë, se cili do të jetë emri, që do të jetë në fletën e votimit.

Z. F. Nuri: Zoti Lako, në shtesë të asaj që doja t’ju thosha, edhe sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e la të kuptohej shumë qartë nga përgjigjja e tij qëparë, se edhe Komisioneri i ka pyetur palët duan apo nuk duan, dhe nga praktikat e mëparshme i kanë pyetur subjektet zgjedhore apo koalicionet nëse kanë dëshirë apo jo. Pra, është në vullnetin e palëve, kështu e kemi kuptuar edhe nga praktika; palët duan që të jetë dikush pse të na e imponojnë të tjerët, domethënë, kur mund ta zgjidhë vetë koalicioni përfaqësuesin e tij dhe është gjëja më normale. Nuk e dimë në qoftë se kjo pastaj do të cenonte dikë tjetër apo një subjekt tjetër, ky do të ishte problem tjetër, po përderisa koalicioni po shpreh vullnetin, është vullneti i anëtarëve të koalicionit. Ne nuk shohim si koalicioni të çfarë të keqe ka nëse koalicioni sot vendosi që të përfaqësohet me zotin Berisha, përkundrazi.

Z. L. Braho: Kam një pyetje për zotin Merkaj. Zoti Merkaj, kjo kërkesa për të përcaktuar përfaqësues të koalicionit, ka ndonjë afat se kur mund të ngrihet, si mund

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

të ngrihet? Pra, kur është afati maksimal, që palët mund të kërkojnë që të vendoset një drejtues për koalicionin; në fletët e votimit flasim gjithmonë.

Z. Y. Merkaçaj: Nuk ka të përcaktuar shprehimisht. Ideja është që kur regjistrohet koalicioni, dokumentacioni që kërkohet nga koalicioni është edhe marrëveshja. Në marrëveshje pastaj specifikohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë partitë dhe partia udhëheqëse. Në rastin konkret nuk është përcaktuar, prandaj iu la edhe koha të dyja koalicioneve: edhe koalicionit “Bashkë Fitojmë” dhe koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë”. Të dy kryetarët ose kryetarët e partive pjesëmarrëse, nuk pranuan të dy koalicionet. Edhe koalicioni Aleanca Liberale e Djathtë...

Z. I. Rusmali: Për zotin Kaziaj kisha një pyetje, që ka lidhje me këtë njoftim. Në fakt, më shumë se një. Për rifreskim, koalicioni juaj nga cilat parti përbëhet?

Z. A. Kaziaj: Nuk jam i qartë zoti... Ishte pyetje retorike, meqënëse ju jeni shumë qartë.

Z. I. Rusmali: Jo, po në seancë publike është mirë t’i themi publikisht gjërat.

Z. A. Kaziaj: Po pra pikërisht se këtë seancë publike, meqë do t’i themi publikisht edhe unë kam për të thënë diçka tjetër publikisht, që ju po merreni vetëm me zotin Kaziaj këtu, si përfaqësues i koalicionit, ndërkohë që jeni vënë në lëvizje nga zoti Sefa, megjithatë për xhentilesë po ju përgjigjem.

Z. I. Rusmali: Dakord, po e tërheq pyetjen.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. A. Kaziaj: Tërhiqeni, se ju bën nder.

Z. I. Rusmali: Zoti Sefa, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, nga cilat parti përbëhet?

Z. I. Sefa: Përbëhet nga Partia e Lirisë, e drejtuar nga zoti Ilir Metaj, nga Partia Demokristiane, e drejtuar nga zoti Nard Ndoka dhe nga Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut, e drejtuar nga zoti Vangjel Dule.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Në qoftë se mund të bëj një pyetje tjetër për zotën Kaziaj, apo nuk doni? Jo e bëj për zotën Nuri pastaj. Zoti Nuri, ju lutem, në qoftë se mund të më thoni, deputeti Sali Berisha, me cilën nga këto 3 parti anëtare të koalicionit është në raporte politike, në kuptimin anëtar ose titullar, ose drejtues i së cilës nga këto 3 parti është?


Z. F. Nuri: Zoti Sali Berisha është në raporte me të gjitha partitë e koalicionit, i nderuar. Ai është lideri historik i së djathtës, i opozitës, siç dihet, në qoftë se do të flasim politikisht dihet pesha e zotit Berisha, kështu që të gjithë partitë e koalicionit...

Z. I. Rusmali: Raportet janë formale, është kryetari i ndonjëres nga këto 3 parti?

Z. F. Nuri: Mund t’i drejtoheni zyrtarisht Gjykatës së Tiranës për ekstraktin, për ta parë atë pjesë në rrugë zyrtare. Në dijeninë time, jo.

Z. I. Rusmali: Nuk është kryetari i asnjëres nga këto 3 parti.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. F. Nuri: Në dijeninë time nuk duhet të jetë kryetari i këtyre partive, por është lideri historik dhe këto parti kanë vendosur që atë të kenë drejtues.

Z. I. Rusmali: Është deputet i ndonjëres nga këto 3 parti?

Z. F. Nuri: Në dijeninë time jo, është i pavarur si deputet, sot që flasim.

Z. I. Rusmali: Është anëtar i forumeve drejtuese të ndonjëres nga këto 3 parti?

Z. A. Kaziaj: Këto nuk janë kërkesa të ligjit, zoti anëtar i KAS-it. Zoti Sali Berisha ka qenë Kryeministër, kur ju keni qenë ministër, zëvendës i tij keni qenë, dhe e dini fare mirë, domethënë, se çfarë pozicioni mban Sali Berisha në këtë moment.

Z. I. Rusmali: Neve na intereson momenti aktual dhe duhet të dimë: është kryetar i ndonjëres nga këto 3 parti të koalicionit, apo jo?

Z. A. Kaziaj: Nuk e kërkon ligji të jetë kryetari i asnjë partie për momentin.

Z. I. Rusmali: A është apo jo, pastaj e kërkon ligji apo jo?

Z. A. Kaziaj: Është fryma e 3 anëtarëve të tjerë, të cilët kanë lidhur marrëveshje në bazë të pikës 3, të nenit 65, që me vullnetin e tyre, të 3 kryetarët e partive caktojnë deputetin Sali Berisha për të pasur emrin e tij në fletën e votimit në numrin 1 rendor të saj. Faleminderit!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Rusmali: Ju jeni në dijeni besoj të faktit që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve partisë, grupimit, quajini si të doni, që drejtohet nga deputeti Sali Berisha i ka ndaluar pjesëmarrjen në zgjedhje, kur ju paraqitët kërkesën tuaj për regjistrimin e koalicionit përfshirë partinë, po të doni, grupimin, e drejtuar nga zoti Berisha. Jeni në dijeni të këtij fakti?

Z. A. Kaziaj: Ne jemi në dijeni të faktit që ju si një anëtar i KAS-it keni dhënë një vendimmarrje kryekëput në kundërshtim me ligjin, duke caktuar zotin Alibeaj si kryetar të Partisë Demokratike. Të këtij fakti ne jemi në dijeni, se e keni dhënë me firmë dhe me vulë.

Z. I. Rusmali: Kjo është çështje tjetër. Jeni në dijeni të faktit që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka ndaluar pjesëmarrjen në zgjedhje të partisë së deputetit Sali Berisha.


Z. A. Kaziaj: Jemi në dijeni të faktit që ju keni bërë një kryetar një person pa pasur rekuizitet e nevojshme, sipas kërkesave të ligjit zgjedhor. Të këtij fakti ne jemi në dijeni.

Z. I. Rusmali: Pyetja tjetër e fundit, sqarimet më mbrapa, po pyetja e fundit. Keni marrë pëlqimin e deputetit Sali Berisha, kur e keni bërë këtë kërkesë?

Z. F. Nuri: Ajo kërkesë nuk është bërë nga ne personalisht, i nderuar.

Z. I. Rusmali: Këtë njoftim. S'ka rëndësi, partitë e koalicionit kanë marrë pëlqimin e deputetit Berisha, kur e kanë bërë këtë kërkesë?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjitha LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. A. Kaziaj: Marrëdhëniet me KQZ-në, i nderuar zoti Rusmali, përfaqësohen nga Partia e Lirisë, si parti udhëheqëse e koalicionit, në bazë të pikës 3.

Z. I. Rusmali: Këtë s'e dëgjova. Parti udhëheqëse e koalicionit, ku është e shkruar kjo?

Z. A. Kaziaj: Në marrëveshjen tonë.

Z. I. Rusmali: Është e shkruar në marrëveshje? Se pak më parë m'u duk sikur thatë që nuk ka marrëveshja përcaktim për partinë.

Z. A. Kaziaj: Është detyrim ligjor.

Z. I. Rusmali: Domethënë, në qoftë se unë lexoj marrëveshjen e gjej fjalinë, parti udhëheqëse e koalicionit është Partia e Lirisë.


Z. A. Kaziaj: E konfirmon edhe sekretari i Përgjithshëm, nuk ka se si të jetë ndryshe se ka ardhur pranë jush, e keni shqyrtuar ...

Z. I. Rusmali: Zoti Merkaj, e konfirmoni këtë?

Z. Y. Merkaj: Është në marrëveshje.

Z. I. Rusmali: Është në marrëveshje, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. A. Kaziaj: Po detyrim ligjor, çfarë është detyrim ligjor, ne e zbatojmë, nuk jemi në kundërshtim me atë që silleni ju.

Z. E. Sefa: Faleminderit!

Z. F. Nuri: Një sqarim të vogël, më fal, zoti Sefa, nëse mundem, gjithmonë me lejen tuaj. Në lidhje me ato që pyeti zoti Rusmali, duke qenë se KAS-i për rastin e mëparshëm analog, për rastin subjekti Parti Demokratike u bazua mbi faktet, po themi, publike dhe nenin 131, pra, faktet botërisht të njohura...

Z. I. Rusmali: Për cilin rast?

Z. F. Nuri: Për rastin e zotit Alibeaj që...


Z. I. Rusmali: Nuk është në vendimin tonë.

Z. K. Bele: Zoti Nuri, më fal, të mos shkojmë mbrapa, rrimë te çështja jonë.

Z. F. Nuri: Thjesht, ta sqaroja këtë gjë, është fakt botërisht i njohur që koalicioni drejtohet *de facto* politikisht nga zoti Berisha dhe nuk ka asgjë të keqe këtu, dhe partitë e koalicionit duan që të përfaqësohen nga zoti Sali Berisha, është fakt publik. Ne nuk mund ta mohojmë që zoti Berisha është duke bërë fushatë zgjedhore.

Z. I. Rusmali: Ne duhet të jemi qartë për raportin juridik midis palëve para se të marrim vendimet. Fakti që politikisht udhëhiqet nga zoti Berisha koalicioni juaj, kjo është gjë publike, nuk themi gjë ne, po ne duam raportin juridik. Ne u trembëm, të

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

themi të drejtën, se thamë mos Berisha, është bërë mbledhje e forumeve drejtuese në Partinë e Lirisë, është shkarkuar Ilir Meta dhe është zgjedhur kryetar Sali Berisha. Këtë ne e eliminojmë, sepse kjo konfirmohet. Raport juridik midis zotit Berisha dhe Partisë së Lirisë nuk ka, apo jo?

Z. A. Kaziaj: Në fakt, domethënë që u trembët më vjen kështu, se keni pas ndonjë traumë, me sa shoh për sa i përket pjesës së marrëdhënies me zotin Berisha, ndaj po i bëni këto pyetje kaq tendencioze. Faleminderit!

Z. F. Nuri: Unë kam vetëm një sqarim të vogël juridik.

Z. K. Bele: Ngelemi te çështja, e ka radhën për të folur zoti Sefa. Më fal, zoti Çefa!

Z. E. Çefa: Faleminderit, që ma thoni emrin me “ç” gjithmonë. Unë kam një pyetje për zotin Sefa, me “s”. Atëherë, zoti përfaqësues i Partisë Demokratike, në objektin e kërkesës tuaj, në paragrafin e 3-të, po e citoj, ju kërkoni ndryshimin e përmbajtjes së fletës së votimit, duke vendosur të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 98. pika 3 të Kodit Zgjedhor, sipas propozimeve të bashkëlidhura. Tani, të lutem, a mund ta specifikoni pak, se unë kuptova deri tani që neni 98 i Kodit Zgjedhor nuk përcakton ndonjë detyrim se cilin duhet të vendosë koalicioni në fletën e votimit si kryetar të tij. Na e elaburoni pak, të lutem, idenë tuaj deri në fund, domethënë që ta kuptojmë të kemi edhe ne transparencë pak.

Z. I. Sefa: Neni 98 pika 3 referon që duhen. Propozimi i bashkëlidhur është ky, që është bashkë me ankimin, neni 98, pika 3 thotë që duhen: sigla, emri, emri i kryetarit në fletën e votimit.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. E. Çefa: E kryetarit të kujt?

Z. I. Sefa: Të subjektit zgjedhor, që në rastin e koalicionit, në bazë të nenit 65 pika 3, partia udhëheqëse e koalicionit, e përcaktuar në marrëveshje, merr të gjitha të drejtat e detyrimet e koalicionit, gjithashtu...

Z. E. Çefa: Neni 98, fjalia e dytë e pikës 3 thotë: “Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë”. Tani për kë e keni fjalën ju për kryetar, ju thoni kryetar të subjektit zgjedhor, konkretisht për kë e keni fjalën? Kujt i referoheni? Cilin emër doni të vendosni në fletën e votimit?

Z. I. Sefa: Neni 65, pika 3 thotë: “Kur kemi të bëjmë me një koalicion zgjedhor, atëherë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara i merr partia udhëheqëse e koalicionit”.

Z. E. Çefa: Të drejtat dhe detyrimet që i burojnë partisë drejtuese të këtij koalicioni, a mund të na i referoni, ju lutem? Dhe në qoftë se e keni në konsideratë edhe marrëveshjen e koalicionit, a mund të ma citoni, të lutem, ku është përcaktuar në këtë marrëveshje vullneti i gjitha partive pjesëmarrëse për të caktuar një X kryetar nga këto parti në fletën e votimit. Në marrëveshjen e koalicionit.

Z. I. Sefa: Thotë partia udhëheqëse e koalicionit, sipas parashikimeve të nenit 65, e vijues të Kodit Zgjedhor, është Partia e Lirisë.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. E. Çefa: Udhëheqëse e koalicionit, patjetër, se ka detyra partia udhëheqëse e koalicionit. Kodi e ngarkon me të drejta dhe detyra, sigurisht. Ju po i referoheni një detyrimi se ju kërkoni ta detyroni, apo jo koalicionin për një veprim të caktuar.

(Diskutime pa mikrofon)

E rifillojmë edhe një herë ku e lamë. Ju lutem, më saktësoni çfarë nënkuptoni në paragrafin e tretë të objektit të ankimit tuaj drejtuar këtij komisioni?

Z. I. Sefa: Detyrimin e çdo subjekti zgjedhor që konkurrën, që të identifikohet me sigël, domethënë me logo, me emër dhe me emër kryetari, duke i bërë në kushte të barabarta të gjitha subjektet zgjedhore që konkurrojnë. Ky është një ndryshim i krijuar në vitin 2020, me ndryshimet e Kodit.

Z. E. Çefa: Pra, detyrimin e çdo subjekti zgjedhor me emrin e kujt kryetari? Tani, në fletë votimi kemi 2 koalicione, apo jo? Vijnë te rastet konkrete të 2 koalicioneve. Kë propozoni ju kryetar në fletën e votimit të këtyre 2 koalicioneve, kë doni t'jua caktojmë ne?

Z. I. Sefa: Nuk e caktojmë as unë, as ju, e cakton marrëveshja.

Z. E. Çefa: Gjithmonë duke iu referuar marrëveshjeve, ju them, ju i njihni marrëveshjet i keni pasur subjekt trajtimi në këtë komision edhe herë të tjera, unë prezumoj që jeni në dijeni shumë mirë të përmbajtjes së tyre. Tani, ju lutem, më thoni, referuar këtyre marrëveshjeve, kë mendoni ju që është vullneti i 2 koalicioneve të përcaktojnë kryetar këtu në këto fletë votimi?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina ÇEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Sefa: Tani te marrëveshja Aleanca Liberale e Djathtë, në mos gaboj unë, është Artur Roshi, Partia Balli Kombëtar.

Z. E. Çefa: Në marrëveshje është caktuar që partitë bien dakord që të jetë emri Artur Roshi në fletën e votimit?

Z. A. Kaziqaj: Të përgjigjet sekretari i Përgjithshëm, që i ka marrëveshjet.

Z. E. Çefa: S'ka problem, i kam edhe unë marrëveshjet këtu, jua vë në dispozicion, po të doni, të dyja.

Z. I. Sefa: Po, në qoftë se e keni marrëveshjen e Aleancës Liberale të Djathtë.

Z. E. Çefa: I kam të dyja.

Z. I. Sefa: Këtë tjetrën e kam unë, vetëm atë dua.

Z. A. Kaziqaj: A mund të përfitoj nga rasti për t'i bërë një pyetje, apo s'keni mbaruar, zoti Çefa?

Z. I. Sefa: Mbështetur në pikën 65, pika 3 të Kodit Zgjedhor, thotë, koalicioni do të drejtohet nga Partia Balli Kombëtar Demokrat, ALD, sigla e koalicionit dhe vazhdon: të bëjë koalicion, të deklarojë marrëdhëniet; detyrimet reciproke të tyre lidhen në marrëveshjen bashkëlidhur dhe kemi marrëveshjen bashkëlidhur

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. E. Çefa: Dakord. E njëjta dispozitë është pak a shumë e parashikuar te marrëveshja e koalicionit tjetër që kemi në fletë votimi. Tani unë dua të di në këto 2 marrëveshje, ku është e përcaktuar që partitë kanë rënë dakord se cilin nga kryetarët e partive përbërëse të koalicioneve specifike të vendosin në fletën e votimit.

Z. I. Sefa: E përcakton ligji.

Z. E. Çefa: Neni 98 nuk përcakton, neni 98 përcakton kryetarin e partisë, jo të koalicionit, apo jo?

Z. I. Sefa: Të përgjigjem?

Z. E. Çefa: Patjetër.

Z. I. Sefa: Neni 98 përcakton detyrimin për t'u vendosur emri i kryetarit të subjektit të partisë politike, neni 65 jep interpretimin e subjektit zgjedhor që thotë: “në rast se keni të bëjmë me koalicion, të drejtat e detyrimet, që janë dhe detyrimet e nenit 98, i merr përsipër partia udhëheqëse e koalicionit.” Dispozita është e qartë kristal.

Z. E. Çefa: Pak gjatë, po ju e thatë përgjigjen që unë jua kërkova. Pra, ju po më thoni që ju kërkoni të vendosim Ilir Metaj te koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe Artur Roshin te koalicioni tjetër.

Z. I. Sefa: Mund të përgjigjem?

Z. E. Çefa: Po, patjetër!

*Zbardhi materialin audio
Mirgjeta LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Sefa: Dhe kjo është duke iu referuar marrëveshjes.

Z. E. Çefa: Pra, këtë kërkon? Jeni duke sqaruar objektin e kërkesës, apo jo?

Z. I. Sefa: Nuk e kërkoj unë, pra e kërkon koalicioni vetë këtë.

Z. E. Çefa: Tani, të lutem, koalicioni po kërkon diçka tjetër.

Z. I. Sefa: Partia udhëheqëse e koalicionit, sipas parashikimit nenit 65 të Kodit Zgjedhor është Partia e Lirisë. Të autorizojmë, thotë, zotin Ilir Metaj kryetar i Partisë së Lirisë ose të autorizuar prej tij të paraqesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe KZAZ-së kandidatë për kryetar bashkie e të gjitha me radhë. Tani, unë nga kjo shkresa shoh Ilir Metaj kryetar partie i Partisë së Lirisë, e cila është drejtuese, udhëheqëse e koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Unë çfarë lexoj referoj në të njëjtën format ishte dhe koalicioni ALD me Partinë Balli Kombëtar Demokrat e gjithë me radhë ...

Z. L. Braho: Një pyetje, se e kam për të dyja palët. Vendosja e emrit të udhëheqësit të koalicionit të kryetarit të partisë që udhëheq koalicionin, për ju është e drejtë, apo detyrim?

Z. I. Sefa: Është detyrim ligjor, për ne është detyrim ligjor, e ka vendosur KAS-i, e ka vendosur Kolegji, e ka vendosur ligji dhe është detyrim ligjor jo e drejtë, nuk është mundësi zgjedhjeje.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. A. Kaziaj: Mundem? Fakti është për ta lidhur pak edhe me pyetjen që zoti Çefa i bëri zotit Sefa. Fakti është që dhe sekretari i Përgjithshëm iu përgjigj disa pyetjeve tuaja lidhur me a është përcaktuar personi përgjegjës që duhet të rezultojë në fletën e votimit të koalicionit, tha jo, për shkak se kjo është shumë e vërtetë. Nuk kemi përcaktuar një person përgjegjës, nuk ka një detyrim ligjor të përcaktosh personin përgjegjës, nuk cedohen të drejtat, sipas nenit të 65, pika 3 nga Partia e Lirisë të personi, që ne me vullnet, të 3 pjesëtarët dhe kryetarët e partive kërkojnë që të jetë në fletën e votimit, dhe si e tillë duhet të jetë fare e qartë, nga ky debat administrativ që po bëhet midis palëve. Doja të pyesja zotin Sefa, në qoftë se më lejohet nga ana juaj, t'i bëja një pyetje. Si të doni, dakord, ishte në kuadër të shtjellimit të gjësë. Po jua bëj juve pastaj.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. A. Kaziaj: Po ja bëj administratës.

Z. K. Bele: Mbarojmë me pyetjet e fundit. Zoti Çefa, dhe pastaj nëse kemi ndonjë prapësim, apo ndonjë pyetje për palët, atëhere keni të drejtën tuaj ta ndani.

Z. F. Nuri: Desha vetëm një qëndrim duke marrë shkas nga pyetja shumë e drejtë që drejtoi zoti Braho, të njëjtën pyetje do t'i bëja dhe unë.

Z. K. Bele: Do hyjmë dhe te ky moment, po ezaurojmë pyetjet tona pastaj mund t'i bëni pyetje dhe njëri-tjetrit.

Z. E. Çefa: Vazhdojmë zoti Sefa bashkë të lutem, atëhere e kuptova që ju kërkonti në kundërshtim me vullnetin e dy koalicioneve, që t'i përcaktoni atyre një kryetar në fletën e votimit, tani pyetja ime është, ky ishte konstatim, pyetja vjen tani, dakord, ja dëgjo, sepse ju sapo më thatë, sapo e pranuat që kërkonti që në fletën e votimit përkrahë dy koalicioneve të vendosen si dy përfaqësues koalicioni, kryetarët e dy partive udhëheqëse të koalicioneve përkatëse, apo jo? Që domethënë, e thënë shkurt, ju kërkonti zotin Ilir Metaj te Koalicioni Bashkë Fitojmë, dhe te koalicioni tjetër kërkonti Artur Roshin, apo jo? Tani unë mendoj këtë, pyetja ime është kjo, a mos ishte ndoshta dhe proceduralisht pak më e lehtë për ju, dhe më pak e sforcuar, që të kërkonit të hiqnit emrin e zotit Alibeaj edhe nga fleta juaj, edhe nga fleta e votimit, mos do ishte ndoshta më e barabartë në kuptimin e barazisë të armëve të palëve në zgjedhje ky, ndoshta dhe më e lehtë për t'ju legjitimuar, se ju tani po kërkonti, po i kërkonti KAS-it që të caktojë edhe drejtuesat e koalicioneve, mund të kërkonti nesër, nuk e di domethënë, ndonjë diçka tjetër që. Tani unë them, mos ishte më e lehtë që

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

të kërkonte heqjen e emrave të zotit Alibeaj dhe gjithë emrave të tjerë nga fleta e votimit dhe të jenë listat e bardha, vetëm emrat e partive dhe koalicioneve.

Z. I. Sefa: Nëqoftë se do ishte në dëshirën time do kisha kërkesa të tjera me thënë të drejtën, por kjo është në dëshirat e ligjit, dhe është përcaktuar në Kodin Zgjedhor, dhe unë nuk kam çfarë t'i bëj ligjit.

Z. E. Çefa: Po pikërisht se ligji, unë nuk e shoh në asnjë vend këtë që kërkonte ju në ligj, prandaj po e bëj këtë pyetje. Ashtu sikundër nuk shoh në asnjë vend në ligj se ku ju prish ju punë mospërcaktimi i personit përfaqësues në fletën e votimit, megjithatë kjo nuk është objekt. Jo faleminderit, s'kam më pyetje.

Z. L. Braho: Atëhere kam këtu përpara marrveshjen e koalicionit, dhe nga përfaqësuesit e koalicionit u ngrit pretendimi që normalisht nëqoftë se do kishte një emër të propozuar nga koalicioni për fletët e votimit, ai do të ishte pjesë e marrveshjes, dhe mesa vë re unë marrveshja është nënshkruar nga kryetarët e partive, nëqoftëse do ishte propozuar emri, do ishte në marrveshje. Tani ju këtu keni ardhur me një shkresë e cila nuk është e tre kryetarëve të partive, por është e një përfaqësuesi të autorizuar. A nuk bie pak kjo ndesh përse i përket legjitimitetit të tij për të zgjedhur tani? Se i bie ai po amendon marrëveshjen, a mundet një njeri të amendoj marrëveshjen?

Z. A. Kaziaj: Mbase bie ndesh me interesat tuaja personale të kësaj pyetje, se unë ja u shpreha vullnetin tim.

Z. L. Braho: O zoti Kaziaj, ju jeni kryetari ndonjëherë prej këtyre tre partive?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. A. Kazi*aj*: Unë jam përfaqësuesi ligjor siç e dini dhe ju.

Z. L. Braho: I kujt?

Z. A. Kazi*aj*: I koalicionit.

Z. L. Braho: I koalicionit që është përshkruar me një marrëveshje të nënshkruar nga tre kryetarët.

Z. A. Kazi*aj*: Po.

Z. L. Braho: Atëhere thashë tre kryetarët nuk kanë shprehur pëlqim thoni ju, për të caktuar një njeri si person.

Z. A. Kazi*aj*: Në marrëveshje thashë.

Z. L. Braho: Marrëveshje jo, atëhere a mundet një njeri tjetër të ndryshojë vullnetin e këtyre tre pesonave, të ndryshojë marrëveshjen?

Z. A. Kazi*aj*: Është vullneti i të gjithëve, të garantoj për këtë, dhe është vullneti i partisë udhëheqëse të koalicionit që ka detyrime dhe të drejta me këtë institucion që ju përfaqësoni sipas nenit 65 ,pika 3, zoti Braho. Është shumë e thjeshtë, nuk mundet të treja partitë të kenë marrëdhënie me institucionin tuaj, për shkak se jo më kot ligjvënësi e ka parashikuar në dispozitën e sapo cituar që duhet vetëm një parti që të

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

merret me të drejtat dhe detyrimet që ka kundrejt institucionit tuaj, është shumë e thjeshtë, nuk duhet as vullneti zotit Dule, as vullneti zotit Ndoka, për këtë komunikim që ju është bërë ju në mënyrë që të rezultojë në fletën e votimit, në numrin 1 rendor të saj emri me vullnet i zotit Sali Berisha.

Z. K. Bele: Më falni zoti Kaziaj pa ju ndërprerë fjalën dhe ju, meqënëse do vazhdoni pyetjet për ekonomi administrative, se ne kemi dhe një proces tjetër më vonë, do lutem ato gjëra që janë thënë të mundohemi mos ti përsërisim, madje po them zotit Braho që këtë pyetje e bëra dhe unë më përpara, kështu që do mundohemi që pa penguar askënd të flasi të bëjmë ekonomi, sigurisht të arrijmë dhe targerat që kemi.

Z. I. Rusmali: Të bëj unë një pyetje që s'e kam bërë më përpara?

Z. K. Bele: Dakord.

Z. I. Rusmali: Shpresoj që do marr përgjigje të shkurtër nga zoti Merkaj, ju thatë në shpjegimet tuaja që fjalia e dytë e pikës 3, e nenit 98, i referohet partive politike, është e thjeshtë ajo është objekti i debatit që kemi ne dhe nuk ka lidhje me koalicionet, tani unë besoj që kam nevojë të dijë, me çfarë argumentimi, arsyetimi ligjor, është vendosur përbri koalicioneve, të dy koalicioneve, sigla shkronjat nistore të anëtarëve të koalicionit, dhe shkronjat nistore të koalicionit, Kush është baza ligjore e këtij veprimi.

Z. Y. Merkaj: Me marrëveshje është përcaktuar me gjithë partitë pjesëmarrëse të koalicionit

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Rusmali: Jo, jo, pse është futur në fletën e votimit, pse në fletën e votimit, pika 3, e nenit 98, thotë për partitë politike përkrahë emrit, përbri emrit caktohet, vendoset sigla dhe shkronjat nistore të partive politike, emri i kryetarit dhe shkronjat nistore të partisë, dhe këtë thamë që është e vlefshme vetëm për partitë politike. Tani pyetja që bëj unë është kush është referenca, cila është referenca ligjore, që përcakton që përbri emrit të koalicioneve, vendoset sigla, shkronjat nistore të anëtarëve të koalicionit dhe shkronjat nistore të koalicionit, po flas për fletën e votimit, jo për marrëveshjen, nuk po them cilat janë këto, por pse vendosen këto.

Z. Y. Merkaj: Referencë është marrë fjalia e dytë e pikës 3, e nenit 98, të gjitha partitë pjesëtare të koalicionit nuk kanë vendosur siglat e tyre të partive të tyre, por kanë vendosur një sigël të përbashkët të treja, dhe kanë kërkuar të treja partitë apo të katërta partitë pjesëmarrëse që kjo sigël përfaqëson këtë koalicion dhe të vendoset në fletën e votimit, e njëjta gjë edhe për shkronjat nistore të koalicionit.

Z. I. Rusmali: Që do të thotë që në rastin e koalicioneve këto janë vendosur se janë koalicionet që i kanë kërkuar, dhe s'kanë kërkuar siglën e tyre, dakord.

Z. Y. Merkaj: Edhë shkronjat nistore nuk janë të partive të tyre por janë të koalicionit.

Z. I. Rusmali: Dakord, domethënë ato kanë kërkuar që t'ju vendosni siglën dhe shkronjat nistore dhe ju ja keni vendosur, nu kanë kërkuar vendosjen e emrit të kryetarit dhe ju s'ja keni vendosur.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Jo nuk kanë kërkuar, po nuk kanë rënë dakord, dhe nuk e kanë vendosur.

Z. I. Rusmali: Dakord, kur e kanë kërkuar dhe në çfarë forme e kanë bërë këtë gjë?

Z. Y. Merkaj: Siç e thashë dhe më parë miratimi i fletës së votimit bëhëet në seancë publike nga Komisioneri, me pjesëmarrjen e përfaqësuesëve të koalicioneve dhe të partive të tjera, bëhet debat, bie në dakortësi.

Z. I. Rusmali: Unë kam procesverbalin e mbledhjes këtu, të mbledhjes publike, nëqoftëse unë e lexoj nga fillimi në fund procesverbalin, do gjej aty kërkesat e dy koalicioneve për të vendosur siglën dhe shkronjën nistore, në fletën e votimit?

Z. Y. Merkaj: Nuk di ta them, duhet ta lexoj, megjithatë kjo ka kaluar në heshtje, nuk është se ka patur debat.

Z. K. Bele: Duke qënë se nuk ka pyetje të tjera ju lutem të arrijmë te qëndrimet e palëve, shkurtimisht, duke qënë se jemi te kërkesat e fundit, zoti Sefa.

Z. I. Sefa: Problemi është se unë, se kjo seancë duhet të mbaj qëndrim dhe në lidhje me këtë, por ngaqë vajti shumë vonë, për të thënë të drejtën, shumë interesante

Z. K. Bele: Po mbaje qëndrimin nuk të pengon njeri se përmbledh një paragraf, ndoshta këto qëndrime do ngelen kur t'i lexojnë njerëzit, kështu që mirë është ti lëmë të gjitha çfarë kemi për të thënë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Sefa: Po se duhet të diskutojmë mbi një njoftim historik që ka ardhur në KQZ domethënë, është...Së pari unë në ankimin tim kam qënë i detajuar dhe nuk kam kërkuar vetëm për Bashkë Fitojmë, kam kërkuar për të gjithë subjektet që janë në listë, propozimi që kam sjellë është për të gjitha subjektet që janë në listë, dhe jam korrekt te ajo pjesë sepse u referua në mënyrë të gabuar që kërkon vetëm për një, jo për gjithë të tjerat, ankimi është për të gjitha, me dy fjalë edhe shkurt, ligji përcakton që duhet të jetë emri i kryetarit, neni 65 thotë kur është subjekt zgjedhor detyrimet dhe të drejtat i merr partia udhëheqëse e koalicionit, në të dyja rastet janë përcaktuar udhëheqëse Partia e Lirisë dhe Balli Kombëtar Demokrat që kanë kryetar përkatësisht zotin ilir Metaj dhe zotin Artur Roshi. Kemi vendim të KAS-it numër 19 të vitit 2021, që thotë që Komisioneri ka të drejtë për të bërë listën e votimit, fletën e votimit por ka disa kufij, që ndër këto kufij është vendosja e emrit të kryetarit, sigla e të gjithame rradhë, kemi dhe vendimin e Kolegjit që është më i detajuar, thotë duhet të jetë patjetër, kemi dhe pastaj procedurën që ka ndjekur Komisioneri në 2021, që përkundër sa thotë ka pëlqimin nga Partia Demokratike me shkrim, që nuk gjendet gjëkund, megjithëse e kërkoi administrata se u vu në lëvizje, nuk e gjeti, fatkeqësisht, e ka fshehur, e keni fshehur me siguri, dhe domethënë është vënë Komisioneri dhe e ka vendosur sipas ligjit, dhe qëndrimi im ndaj Komisionerit ka qënë o ke shkelur ligjin atëhere o po shkel ligjin tani. Tani zgjidhja është në dorë të Komisionerit, nuk mu përgjigj, gjithsesi, ne, ankimi është i qartë, bazohet në nenin 98, pika 3, dhe nenin 65 pika 3, propozimi jonë duhet të jenë të gjitha subjektet duhet të jenë të barabarta përpara ligjit, dhe të barabarta përpara zgjedhësve, zgjedhësit të kenë mundësi të identifikojnë qartësisht subjektin dhe drejtuesin e tij, dhe kjo është një detyrim ligjor. Konkretisht pastaj kemi sjellë dhe propozimin që besoj që është bashkëlidhur dhe ankimi që duhet të jetë kryetar dhe përbërja e partive të anëtarëve të koalicionit, siç e ka 2021, se në 2021 po ta shikoni janë këtu PD, PR, PDIU, PA,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

patjetër, tani qytetari, jo nuk janë, Komisioneri ka menduar që mos ta cilësoj fare si koalicion. Komisioneri, propozimi jonë ky, po të shohësh fletën e votimit propozuar nga Komisioneri, nuk duket fare si koalicion, duket si subjekt, subjekt pa kryetar, edhe është një avancim mbi. Edhe qëllimi, se kjo ha dhe një minutë më shumë kohë ju lutem, pse mendojmë që është e qëllimshme, sepse lidhet pikërisht, jo jo, do ta them këtë të lutem se e kam të nevojshme, lidhet pikërisht me këtë marrëveshjen, ku te kjo marrëveshja fuguron dhe emri Partisë Demokratike. Ky është qëllimi, dakord pra dakord, ndaj ne kërkojmë që fleta e votimit të jetë koalicioni, siglat, domethënë shkronjat nistore të partive përbërëse të tij, emri e kryetari të partisë drejtuese të koalicionit, udhëheqëse të koalicionit dhe të jetë fletë e plotë, siç kemi rastin shumë pozitiv të fletës së 2021, që ka kaluar çekime nga KAS-i, nga Kolegji e të gjitha me rradhë.

Z. L. Braho: Edhe një herë që të jemi të qartë, ju doni që të shkruhet dhe fjala koalicion para, apo jo?

Z. I. Sefa: Jo, vetëm këto PL,PA

Z. L. Braho: Po pra emri koalicionit edhe

Z. I. Sefa: Po, po. Zoti Cefa, të lutem, kur unë të them në ankim sipas propozimit bashkëlidhur.

Z. A. Kaziaj: Po më fal, nuk mund të propozojë një fletë votimi tani një anëtar i një partie tjetër, çfarë është kjo? Prova propozimi bashkëlidhur, që e ka bërë te fotokopja e zyrës. Po ç'është kjo tani. Po kjo s'është provë, çfarë është kjo tani.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. L. Braho: Zoti Kasiaj, dhe vendimi i KAS-it i 2021 ka qënë me aneks, bashkëlidhur me fletë votimi, nëqoftëse e mban mënd, se duhet ta mbash mend.

Z. A. Kaziqaj: Cili vendim i KAS-it?

Z. L. Braho: Ai i 2021 që u la në fuqi.

Z. K. Bele: Mos ta bëjmë debat se jëmi në fund, ai mbajti një qëndrim, i cili mund të jetë ose jo në përputhje me ligjin, bëj prapësimin sapo të vijë rradha, dakord? Kështu që rrimë aty, të lutem mbaro, konkludo.

Z. I. Sefa: Siç jeni në dijeni, përpara se Komisioneri të miratojë fletën e votimit, na ka çuar për njohje të gjithë propozimet e tij dhe ne kemi mbajtur prapësimet tona, te këto prapësime ja kemi çuar dhe Komisionerit, i kemi bërë dije atij me email zyrtare. Tani unë në ankimin tim kam qënë shumë i kujdesshëm kur kam bashkëlidhur dhe propozimin tim, edhe normalisht kur them sipas nenit 98, pika 3, sipas propozimit bashkëlidhur, unë as nuk kam ndryshuar ankim, as nuk kam dal tej.

Z. K. Bele: Përfundimisht të lutem.

Z. I. Sefa: Përfundimisht kërkoj pranimin e ankimit, ndryshimin e përmbajtjes së fletës së votimit, sipas propozimit që kam sjell.

Z. K. Bele: Dakord, faleminderit. Përfaqësuesi, po zoti Nuri.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. F. Nuri: Faleminderit, atëhere po e nis nga konkluzioni, ne përfundimisht duam që kërkesa të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova, dhe pa legjitimitim njëherë në rradhë të parë por ajo kaloi, argumenti kryesor është, që dhe ju mos të shfokusoheni, është pyetja, a është e drejtë apo është detyrim që të regjistrohet emri i në fletën e votimit të kryetarit të koalicionit. Po të ishte detyrim të nderuar zonterinj, ju u ankimua në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në KAS dhe në Kolegj regjistrimi i koalicionit tonë, po të ishte detyrim ligjor s’do ta kishin regjistruar fare KQZ-ja sepse do ishte tagër specifik i detyrueshëm, o do sjellësh emrin që ke në fletën e votimit, ose jo, nuk ta pranoj koalicionin për t’u regjistruar në KQZ. Fakti që ky nuk është një detyrim dhe e kaloi koalicioni filtrin dhe të KAS-it dhe të Kolegjit Zgjedhor, tregon që nuk është detyrim ligjor por është e drejtë. Të drejtat ne si koalicion i vendosim vetë, si koalicion duam të përfaqësohemi me një emër në fletën e votimit apo jo. Kështu që këtu mendoj që çdo gjë ezaurohet me këtë. Nëqoftëse është e drejtë atëhere i takon koalicionit dhe asnjë subjekti tjetër të cakojë se çfarë do bëjë koalicioni me fletën e votimit të saj. Dhe një element të fundit të lutëm pastaj të vazhdojë kolegu Kaziaj, dhe një element të fundit pastaj do ja lë fjalën kolegut Kaziaj, do prapësoj gjithashtu një argument që u përfoj këtu, se Kolegji Zgjedhor na paska thënë se qënka detyrim për koalicionet të vendoset logjoja dhe emri i kryetarit në fletën e votimit, nuk më rezulton, vendimi në lidhje me Bindjen Demokratike, flet vetëm për logon e asaj partie politike, nuk flet fare për koalicion. Nuk e di nëqoftëse e kam vëmëndjen akoma të anëtarëve të KAS-it. Në lidhje me, të nderuar anëtar, nëse mund të kem vëmëndjen tuaj ju lutem, dhe së fundi ju flas ju si KAS në përgjithësi, po ju referuar dikujt specifikisht, nga pyetjet që u ngritën qëpar në debatin kontradiktor, u ngrit dhe çështja a është marrë dakortësia apo jo e palëve politike. Për analogji, përsa kohë nuk e kundërshton njeri nga koalicioni jonë, nga partitë përbërëse të koalicionit, dhe letra, shkresa që ju ka ardhur përpara

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

tavolinës është nga zoti Endrit Brahimllari që i ka të gjitha traget për të përfaqësuar koalicionin, për analogji edhe KAS-i kështu vendosi dhe në rastet e kaluara ku përderisa nuk kishte kundërshtime për rastin e zotit Alibeaj, u morr e mirëqënë se nuk kishte kundërshtime. Pra dhe këtu merreni për analogji se përderisa s'ka kundërshtime nga anëtarët e tjerë koalicionit, merreni të mirëqënë se zotin Berisha e kanë pranuar dhe anëtarët e koalicionit, së fletës së votimit. Faleminderit!

Z. K. Bele: Përsa ju parashtruat nëse e kuptuam drejtë, kjo është pjesë e kerkimeve tuaja.

Z. A. Kaziaj: Po, ajo është pjesë e kerkimit tonë dhe qëndrimit tonë zyrtar, dhe të partive përbërëse të koalicionit, të përfaqësuar nga Partia e Lirisë. Fakti është që me këto ndryshime që kemi në këtë seancë pranë jush, kërkojmë nga ana juaj ndryshimin e pjesëshëm të vendimmarrjes së Komisionerit, duke përcaktuar emrin e zotit Berisha, përbri numrit një, të Koalicionit Bashkë Fitojmë.

Z. K. Bele: Më fal zoti Kaziaj, nëse e kuptova drejt kërkesa, qëndrimi i mbajtur nga zoti Nuri ishte rrëzimi i padisë, në eksperiencën time, rrëzimi i kerkimit, siç e kuptova unë ju po thoni nëse do pranohet të pranohet me këtë objekt se nuk i shoh kur rrinë të dyja, apo është alternative.

Z. A. Kaziaj: Pranimin e pjesëshëm me objektin që unë sapo thashë.

Z. L. Braho: Pranimin e pjesëshëm të ankimit të zotit Sefa? Pranimin e pjesëshëm të ankimit të zoti Sefa, pra që të vendoset një emer por

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. A. Kaziaj: Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke specifikuar vullnetin e palëve firmëtare në këtë komunikim të bërë zyrtarisht dhe publikisht nga ana jonë. Kjo ishte qëndrimi.

Z. K. Bele: Mirë, faleminderit. I mbaruam, foli ai për kërkimin e tyre, ju lutem zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Për rrëzimin e ankimit numër 50, me ankues Partia Demokratike, lënien në fuqi vendimin numër 360, 361 dhe 362, datë 15.04.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit.

Z. L. Braho: Po për kërkimin e koalicionit.

Z. Y. Merkaj: Rëzimin dhe të tij.

Z. K. Bele: : Dakord, në këtë fazë tërheqje për vendim, duke qënë se çështja është mjaftueshëm komplekse, ne po tentojmë që për 20 minuta të mblidhemi, në rast se do të ketë si në praktika të mëparëshme, në rast se do të kemi shtyrje, do ju njoftojmë dhe besoj e kemi mirëkuptimin tuaj. Faleminderit, me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

Rifillon seanca

18:42

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. K. Bele: Mirë riçelim seancën, në përfundim të shqyrtimit mbasi analizuam provat në tërsi, KAS me shumicë votash në mbështetje të nenit 21 të Kodit Zgjedhor, vendosi:

- pranimin e pjesshëm të kërkesës së Partisë Demokratike sa i takon pasqyrimin të emrit të kryetarëve të partive udhëheqëse të koalicioneve: Bashkë Fitojmë dhe Aleanca Liberale e Djathtë në fletën e votimit.
- Rrëzimin e kërkesës të Partisë Demokratike për pasqyrimin e shkronjat nistore të partive përbërëse të koalicioneve përbri emrit të koalicioneve përkatëse.
- Rrëzimin e kërkesës së Koalicionit Bashkë Fitojmë për vendosjen e emrit të zotit Sali Berisha në fletën e votimit si drejtues i Koalicionit Bashkë Fitojmë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen e internetit të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur. Faleminderit.

Vendimi nr. 61

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



RENDI I DITËS

Shqyrtimi i kërkesës ankimore numër 51, subjekti ankues Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. E. LAKO, Z. E. ÇEFA, Z. I. RUSMALI,
Z. K. BELE, Z. L. BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y.Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** PD, BF

Z. L. Braho: Mirëmbërma! Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore numër 51 të depozituar në KQZ nga subjekti zgjedhor koalicioni Bashkë Fitojmë. Objekt ankimi i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 360 datë 15.04.2023. Po ashtu është objekt ankimi kundërshtimin i vendimit të Komisionerit numër 363 datë 15.04.2023. Vendime këto që kanë të bëjnë me miratimin e fletëve të votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie në Bashkinë Tiranë dhe 60 bashki të tjera. Dhe pika e tretë e kërkesës ankimore është shfuqizimi i këtyre vendimeve duke vendosur ndryshimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 61 bashkitë e vendit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, duke hequr logon e partive dhe/ose të koalicioneve nga përmbajtja e fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie. KAS ka vendosur që kjo kërkesë ankimore kalon për shqyrtim sot pasi i plotësonte elementët e formës dhe të përmbajtjes. Të pranishëm në shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore është përfaqësuesi i koalicionit Bashkë Fitojmë.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. F. Nuri: Franci Nuri, prezent.

Z. L. Braho: Dhe përfaqësuesi i palës së interesuar Partia Demokratike e Shqipërisë.

Z. I. Sefa: Indrit Sefa, prezent.

Z. L. Braho: Po ashtu i pranishëm është dhe përfaqësuesi i KQZ-së, Sekretari i Përgjithshëm, zoti Ylli Merkaj. Ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët? Atëhere zoti Nuri, shkurtimisht përmbajtjen e ankimit dhe çfarë kërkoni nga KAS.

Z. F. Nuri : Po, faleminderit i nderuar. Shumë shkurt ne nëpërmjet këtij ankimi kemi kundërshtuar vendimin 360 dhe 363 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nëpërmjet këtyre vendimeve Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar përmbajtjen e fletës së votimit për Kryetar Bashkie Tinanë për zgjedhjet vendore të 14 majit. Gjithashtu me vendimin e dytë të atakuar, numri 363 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët në 60 bashki të tjera. Pse e kundërshtojmë ne? Ne e kundërshtojmë sepse gjykojmë se logot e partive dhe të koalicioneve janë tashmë prezente në fletën numër dy të votimit që është fleta ku janë lista shumëemërore të kandidatëve të propozuar nga subjektet dhe koalicionet. Gjykojmë se kjo mund të sjellë komfondim në ditën e zgjedhjeve përderisa kandidatët për kryetar bashkie në rradhë të parë prezantojnë veten e tyre pavarësisht se kanë atë që quhet ndorsën, pra mbështetjen nga partia apo nga subjekti. Ne gjykojmë se emri i kandidatit është më i rëndësishëm për kryetar bashkie për zgjedhësit dhe ai duhet të dali në pah. Pa u zgjatur duke marë shkas edhe nga praktika e viteve të shkuara të ndjekura nga Komisioni Qendror i

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Zgjedhjeve ku kanë miratuar modele fletë votimi pa logo, thjeshtë me emër, numër rendor të tilla si këto për shembull të vitit 2015 apo 2019. Nëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve këto i ka miratuar në ato vite dhe këto kanë qenë të ligjshme për periudhën nuk besojmë se ka ndonjë shkelje ligjore nëse logot e subjekteve hiqen dhe nuk përfshihen as kësaj rradhe. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Nuri. Fjala për përfaqësuesin e palës së interesuar, zoti Sefa çfarë qëndrimi keni në lidhje me këtë kërkesë.

Z. I. Sefa: Unë mendoj se ky ankim duhet të rrëzohet si i propozuar në ligj. Normalisht zoti Nuri pretendoi se ka praktika të vitit 2015, mund të mari praktika të vitit 2007, 2003 por kemi edhe një praktikë të vitit 2022 në të cilën me ndryshimet e reja të Kodit Zgjedhor dhe Komisioneri me detyrën e tij ka propozuar një format flete votimi për kandidatët për kryetar bashkie të cilët kanë edhe logon. Kjo fletë votimi nuk është kundërshtuar nga asnjë nga subjektet dhe ka qenë në fuqi dhe është përdorur gjatë zgjedhjeve të pjesshme vendore të vitit 2022. Gjithashtu edhe neni 98 thotë që në fletën e votimit do të jetë patjetër edhe sigla e subjektit. Përsa kohë që kandidatët janë të përfaqësuar nga subjekti zgjedhor dhe nuk janë kandidat të cilët janë të propozuar nga 1% e zgjedhësve por janë të mbështetur nga subjekti zgjedhor atëhere unë besoj që dhe për identifikimin e tyre do të ishte e nevojshme edhe paraqitja e partisë e cila i ka propozuar këta kandidatë për kryetar bashkie. Përsa kohë këta kandidat bëjnë edhe fushatën zgjedhore të mbashtetur nga subjekti zgjedhor që i ka mbështetur atëhere mendoj që pasja e simboleve/logos në fletën e votimit është e detyrueshme: Siç e citova dhe më parë është edhe vendimi i kolegjit i cili e përcakton që logo në fletën e votimit është një aspekt i detyrueshëm nga ligji. Unë në vrazhdën edhe të diskutimit mëparshëm, të

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

ankimit dhe të qëndrimit të mbajtuar dhe nga palët po bëj edhe një kërkim të ri, ku mendoj që përbri emrit të partisë në fletën që ka propozuar nga Komisioneri që është subjekti zgjedhor të vendoset dhe emri i kryetarit të subjektit zgjedhor. Në rastin konkret nëse ky informacion do të ishte shumë i komplikuar dhe do të krijonte paqartësi tek zgjedhësit atëhere është në...

Z. L. Braho: Pra që ta kuptojmë kërkesën, ju kërkoni që këtu në krah të vendoset dhe emri i kryetarit të partisë apo..

Z. I. Sefa: Poshtë, po.

Z. L. Braho: Në krah të subjektit?!

Z. I. Sefa: Po! Lëvizja Bashkë, Arlind Qorri.

Z. L. Braho: Po adresën e selisë dhe numrin e telefonit?

Z. I. Sefa: Mirë do ishin edhe ato... Në rastin tonë kemi pak probleme se kemi këtë punën e selisë po mirë do ishte...

Z. L. Braho: Ju e keni ndryshuar selinë zoti Sefa?

Z. I. Sefa: Nga rrethanat, kemi komunikuar me KQZ-në një adresë të re. Por KQZ-ja vazhdon i dërgon atje...

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. L. Braho: Po mire, na i dorëzoni këtu që ta kemi për provë. Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Për zotin Nuri doja të bëja një pyetje. Ju thatë që informacioni që jep sigla është informacion që tregon mbështetjen që partia i jep kandidatit në mos gaboj? Kjo është. Ky informacion është i marrë nga fleta e votimit të kuptohemi është i dobishëm për zgjedhësit, është i dëmshëm për zgjedhësit apo zgjedhësit janë indiferent, nuk e konsiderojnë atë? Në vlerësimin tuaj.

Z. F. Nuri: Nuk do të thosha se është i dëmshëm, apo është indiferent nuk do të shprehësja në asnjë nga këto cilësime. Në gjykimin tim mund të sjellë komfondim për zgjedhësit duke qenë se këto janë zgjedhje vendore, lokale dhe nuk janë zgjedhje për subjektet politike. Për mendimin tim personal nuk jam aspak dakord që dhe posterat apo edhe banerat e subjekteve politike të identifikohen me kryetarin e partisë për shembull, gjithmon pa lidhje me këtë ankim. Sepse janë kandidatët për kryetar bashkie dhe qytetarët duhet të njohin në rradhë të parë kandidatët. Duhet të identifikojnë në gjykimin tim kandidatët për kryetar bashkie gjithmon nëse po flasim për fletën e votimit për kandidatët. Prandaj në gjykimin tim aspekti i partisë, i koalicionit apo i logos që e mbështet këtë kandidat duhet të jetë sekondar në këtë fletë votimi. Aq më tepër që kemi fletë votimi numër dy ku aty ato janë të përfshira me emër, me logo edhe me emër gjithsesi. Kështu që gjykoj që nuk ka vënd që ti kemi të dyja sepse nuk do të kuptohet qartë nga zgjedhësi seku është kandidati dhe ku është partia. Mund të jetë tendenca që zgjedhësit do të votojnë, do të shkojnë për të votuar subjektin për shëmbull, ndërsa duhet të jenë të prirur për të zgjedhur kandidatin më tepër se sa subjektin. Pra mos të ndikohen nga subjekti.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Rusmali: Prezenca e logos, e siglës mund ti çojë zgjedhësit drejt një votimi propocional, jo një votimi maxhoritar.

Z. F. Nuri: Po edhe ashtu mund ta marrim, ose një far orientimi, ose keqorientimi pse jo!

Z. L. Braho: Faleminderit! Pyetje tjetër? Zoti Merkaj ju çfarë qëndrimi keni si KQZ në lidhje me këtë kërkesë të koalicionit Bashkë Fitojmë?

Z. Y. Merkaj: Ne mendojmë se kërkesa është e pambështetur në ligj. Konfiguracioni i fletës së votimit që ka miratuar Komisioneri është më qartë duke ju referuar edhe nenit 67 të Kodit Zgjedhor që subjektet ose kandidatët për kryetar bashkie janë mbështetur nga subjektet zgjedhore dhe si i tillë duhet të identifikohet edhe subjekti. Fletët e votimit me evidentim të subjektit është më e qartë për zgjedhësin mendoj unë. Duke qenë se mbështeten nga një parti politike. Për kandidatin që propozohet nga zgjedhësit është pa logo.

Z. L. Braho: Faleminderit. Po zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Meqenëse teza e kolegut Nuri mu duk mjaft interesante. Kolegji Zgjedhor në vendimin e vet të famshëm i ka kërkuar një trupe si puna e KAS-it që kur jep gjykime për fletën e votimit nuk mund ti vendos gjykimet mbi baza subjektive, duhet ti ketë të provuara ato. Në raport me siglëm prezente në fletën e votimit për kandidatët për kryetar bashkie kemi mundësi ne të shënjojmë ndonjë provë që sigla mund ti dërgojë ata drejt votimit propocional. Votim ky që është i ndryshëm nga votimi që po kryejnë, nga zgjedhjet e mëparshme, ndonjë

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

indikacion, ndonjëgjë... Ku di unë! Ndonjë sondazh, ndonjë eksitpoll që t'na japë mundësinë që të dalim në këtë konkluzion mbi baza të sigurta.

Z. F. Nuri: Sikundër jua thashë edhe më parë në vlerësimin tim mund të sjelli komfondim për shkak se kemi dy fleta votimi dhe logo apo emblema, simboli i koalicionit është i përfshirë tek të dy fletët e votimit. Nëse nuk dallohet qartë fleta e votimit për kandidatët nga fleta e votimit proporcional, egziston risku i asaj që ju thatë që votuesi të jetë i prirur më tepër për të votuar partinë pavarësisht cilin kandidat ka nxjerrë partia. Pa bërë ai zgjedhjen reale si zgjedhës.

Z. I. Rusmali: Diçka..... nuk kemi?

Z. F. Nuri: Jo nuk kam.

Z. L. Braho: Faleminderit! Nëqoftëse nuk ka pyetje të tjera ftojme palët për... Po!

Z. F. Nuri: Vetëm një pyetje i nderuar se ju ndërpreva, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve: A mund të na vendosi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve praktikën apo të na shpjegojë pse në zgjedhjet e kaluara nuk është vendosur logoja? Se është në interesin e të gjithëve.

Z. I. Rusmali: Është me interes, po!

Z. F. Nuri: Unë nuk kam asistuar në vitet e shkuara pjesën e proceseve zgjedhore, do ta kisha pse jo dëshirë që ta dija.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. I. Rusmali: Në fakt është diskutuar, ka pasur...

Z. F. Nuri: Edhe një pyetje të dytë po për përfaqësuesin e Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me ndryshimet dhe mendimet ligjore. Kolegu Sefa përmendi se ka patur ndryshime edhe ne 2020 mos të gaboj a i kanë prekur këto hamendime, këto ndryshime pikërisht këtë pjesë dhe e kanë bërë pra të detyrueshme që logoja të jetë prezente? Faleminderit.

Z. Y. Merkaj: Në zgjedhjet e kaluara, nëse do të marrim zgjedhjet e pjeshme të 6 marsit 2022 që u votua për kryetar bashkie në gjashtë njësitë zgjedhore, është vendosur logo, emri i partisë dhe siglat shkrimet nistore të partisë.

Z. I. Rusmali: Ka pasur debat?

Z. Y. Merkaj: Ka pasur debat por është lënë. Por unë mendoj që ka qenë një zgjedhje shumë e mire dhe ka rezultuar shumë e suksesshme pasi kanë qenë dy, tre kandidatë, fleta është A4 dhe është kuadrate. Konfigurimi i fletës së votimit duket qartësisht dhe është më e qarte, është e kundërta e asaj që thotë pala ankuese (që komfondon zgjedhësit). Është shumë e qartë po të ketë dhe logon e partisë.

Z. F. Nuri: Jo, pyetja ime ishte edhe për ato zgjedhje që unë e solla si shembull ku nuk ka qenë prezente logoja. Pra në 2019 po themi mos të shkojmë deri tek 2015. Mbi ç'bazë ligjore apo praktike Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vepruar. Kjo ishte thelbi i pyetjes time. (pyetjes së parë)

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Tek zgjedhjet e kaluara në 2019 ka pasur vetëm emrin e partisë dhe shkronjat nistore ose emrin e koalicionit, poshtë emrit të kandidatit. Mungonte sigla. Në zgjedhjet e tjera u mendua...

Z. F. Nuri: Po mbi ç'bazë ligjore?

Z. Y. Merkaj: identifikohet më mirë kandidati për kryetar bashkie.

Z. L. Braho: Për ta qartësuar zoti Merkaj është diskrecion i Komisionerit ai vendos logot apo jo?

Z. Y. Merkaj: I Komisionit, ka qenë debat dhe ka rënë në një konsencius dhe është menduar që është më mir sepse duket më qartësisht. Identifikohet më qartë emri i kandidatit duke pasur edhe logon përbri.

Z. I. Rusmali: Konsiderata po themi materiale, financiare ose si quhet ka pasur në atë kohë? Ta heqim siglën se na kushton më shumë për shembull.

Z. Y. Merkaj: Nuk e di është një shifër e papërfillshme që nuk besoj se ndikon...

Z. F. Nuri: Po në lidhje me pyetjen e dytë ju lutem. Në lidhje me hamendimet ligjore të Kodit Zgjedhor të vitit 2020 meqenëse kolegu Sefa e përmendi a i cekin këto ndryshime ne gjykimin tuaj detyrimin për përfshirjen e logos apo jo?

Z. E. Çefa: Unë kam një pyetje për përfaqësuesin e Komisionerit për zotin Merkaj. Në opinionin tuaj ose të Komisionerit të dy variantet e fletës së votimit i kënaqin apo i plotësojnë kërkesat apo specifikimet që ligji jep për fletën e votimit apo një

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

nga variantet mund të jetë dhe në kundërshtim me ligjin? Dhe nëse po me cilën dispozitë?

Z. Y. Merkaç: Mendoj që i plotësojnë të gjitha kërkesat e ligjit dhe nenin 98, pika 3 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 67 pasi edhe kandidatët që janë kandidat për kryetar bashkie janë subjektet zgjedhore. Mbështeten nga një parti politike. Kodi nuk e ka të ndaluar që të kenë edhe siglën e Partisë ose subjektit zgjedhor që mbështet këtë kandidat. Identifikohet më qartë në arsyetimin dhe mendimin e Komisionerit. Kështu është menduar si më e qartë dhe nuk komfondohen zgjedhësit madje qartësohet më thjeshtë zgjedhësi, orientohet më thjeshtë në fletën e votimit.

Z. E. Çefa: Pra Kodi nuk e ndalon dhe as nuk e detyron, po themi, që të jetë sigle. Faleminderit!

Z. L. Braho: Dakord nëse nuk ka pyetje të tjera zoti Nuri është radha juaj për konkluzionet përfundimtare. Pra çfarë kërkon përfundimisht nga KAS dhe pastaj radhën e ka zoti Sefa.

Z. F. Nuri: Po i nderuar, faleminderit. Marr shkas edhe nga pyetjet për të shtjelluar me dy sekonda argumentin pse jo të ekonomisë dhe të aspektit ekologjik. Heqja e logove nga fleta e votimit, nga printimi do të kursente pse jopara por edhe do të ishte më mirë për ekologjinë sepse do të hiqeshin të gjitha këto logo me ngjyra. Dihet që bojrat, ngjyrat kanë impakt ekologjik. E di që në Shqipëri nuk merren njeri shumë me keto gjëra por pse jo të fillojmë tani sa më e thjeshtë të ishte fleta e votimit në gjykimin tonë do të ishte në të mirë të të gjithëve. Gjithashtu do të kushtonte edhe me pak buxhetit të KQZ-së dhe buxhetit të shtetit në përgjithësi.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

Nisur nga kjo dhe nga argumentat e tjerë që unë paraqita kërkoj pranimin e kërkesës sipas objektit. Faleminderit!

Z. L. Braho: Po. Fjala për ju zoti Sefa, në lidhje me ankimin dhe në lidhje me kërkesën tuaj.

Z. I. Sefa: Në lidhje me rrëzimin e ankimit të palës kërkuese dhe pa hequr dorë nga kërkesa ime për pasqyrimin që mund të na rëndojnë buxhetin e KQZ-së edhe shtimi i këtyre fjalëve.

Z. L. Braho: Shumë mirë, faleminderit. Zoti Mekaj, ju?

Z. Y. Merkaj: Kërkojmë rrëzimin e kërkesës së koalicionit Bashkë Fitojmë dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Faleminderit.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit. Atëherë KAS do të tërhiqet për vendim. Besoj për 15 minuta, shpallet vendimi.

Rifillon mbledhja

Ora 19:26

Z. L. Braho: Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 51 të depozituar nga subjekti zgjedhor koalicioni Bashkë Fitojmë. KAS pasi u tërhoq për vendim bazuar në provat e depozituara nga pala ankuese dhe Kodi Zgjedhor me shumicë votash vendosi:

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2023*

- Rrëzimin e kërkesës ankimore numër 51 të paraqitur nga koalicioni Bashkë Fitojmë.
 - Ky vendim do të botohet në faqen zyrtare të KQZ-së dhe hyn në fuqi menjëherë.
 - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në kolegjin zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda pesë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- U shpall sot më datë 19 prill 2023. Deklarojmë seancën të mbyllur.

Vendimi nr. 62

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

